

DITURIJA

E PËRKOHËSHMË SHQIPËTARE

Del një herë në muaj

DREJTONJËS: LUMO SKENDO

MBAN:

Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekëllit të 19-të. — Disa dorëshkrime shqip me germa tyrqishte. — Copa historije. — Kënka e sprasme e Ballës. — Bibliografi.

TIRANË
LIBRARIJA LUMO SKENDO
1927

DITURIJA, për një mot, № 1 gjer më 12,
pajtimin e ka 10 franga ar për tekdó në Shqipëri.

Jashtë Shqipërisë pajtimin është 2 dollarë.

Atyreve që akoma s' kanë dërguarë pajtimin, u
lutemi të na e çojnë pa vonuarë më teprë.

Kondita për Arsimtarët:

Për trupin arsimor, si edhe për nxanësit dhe
nxanëset, pajtimi i revistësë po bëhetë 7 franga ar
në mot.

Këtë zbritje po e bëjmë si një lehtësim vetëm për
mësuës dhe nxanësit, dhe do tá mbajmë gjer në krye
të muajit Gusht.

Zotërinjtë që s' e marrin me regull revistën tënë,
janë të luturë të bëjnë ankime dhe qarje në drejtorí e
postavet, në vënt ku gjendenë, dhe këtú në Tiranë.

Koleksioni i Diturisë 1909, një volum, shitetë 20
lek. Me postë 24 lekë.

Numëret 1 dhe 3 të Diturisë 1916, shitenë nga 6
lek copa, bashkë me të hollat e postësë.

Vihetë në shtyp
për së shpejti

Kalendari Kombiar
Dërgoni që tani pajtimin, në adresë të kësaj Reviste.

DITURIJA

E PËRKOHËSHME SHQIPËTARE

Del një herë në muaj

Volum i dytë

1 QERSHOR 1927

Numur 8

Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer ne funt të shekëllit të 19-të

Një Frances, Jacob Spon, mjek në Lyon, ka bërë në shekëll të tetëmbëdhjettë, udhëlim të gjatë në Tyrqi, dhe, duke shkuarë ka parë edhe pakë vënde të Shqipërisë mjerisht vetëm disa pika, kështu që, vepra e tij aq' e vlefshme për Greqinë, Stambollin dhe viset e tjerë të Tyrqisë, mban fort pakë shënime mbi vëndin tënë, dhe këtë vetëm në volym të parë¹.

Spon-i e zë ngoj Shqipërinë duke arriturë, pas Raguzë dhe Korrorit, në Budua që e quan *i fundit qytet që kanë Venecianët në Shqipëri*; pastaj sheh Ulqinin, me shtat' ose tetë mijë banorë dhe skel' e mirë për tregëli në të cilët Frëngjtë kanë një konsul. Durrësi i duketë me një fortesë të shkatëruarë. Kur shkon në Vlorë thotë: „Tri-dhjetë mile lark, brënda në sterret, është një mal në të cilët gjendet një burim sere, që e kanë zënë ngoje edhe të moçmët; me këtë serë, duke e përzierë me katran, kalafatojn' anijetë . . . Me qënë se era qe e favorëshme nukë qëndruamë në Sazano, po vazhduam' udhën . . .

Më siprë (faqe 117, vol. 1) kishte thënë se Sazani ka një rreth gjashtë mijlesh; taní na dëftën një ngjarje që kishte ndodhurë pakë vjet më parë në këtë nisi, pas rrëfimit që i bën një kryetar i çurmës' s' anijesë: kur kishte hedhurë hekurin ne Sazan, me një anije tjetrë, dy galerianë të çurmësë iknë dhe u-pshehnë në drizat e nisisë, gjer sa u-nis anijeja; bashkë me tá kishte ikurë edhe një galerian² tjetrë. Të dy ga-

¹ Voyage d'Italie, de Dalmatie, de Grèce et du Levant, fait ès années 1675 et 1676 par Jacob Spon docteur Medecin Agrégé à Lyon, et Georges Wheler, Gentilhomme Anglois. 3 volyme. Lyon 1688.

² Përdor fjalën galerian për të dëftyerë të dënuarët që i vinin moti të leniq rema në anijet.

lerianët e parë, duke parë se nukë dukësh no një anije ose barkë që të vijë t'i marrë, dhe me qenë në rezik të vdesin uri, vranë shokun e tyre dhe u-ushqyenë me mishin' e tij.

Për Bregun e Detit udhëtari na kallzon se nuk' i bindetë Tyrkut dhe s' i pagon haraç; limani, Portó Palermo, është mjaft i mirë, po anijet s' kuxojné të hedhin hekur se, thuhetë për Himariotët që shesin të Krishterët ne Tyrqit, dhe Tyrqit të Krishterëvet

Më poshtë, faqe 137-141, autori flet pakë për Prevezë, Nartë . . . po jo duke i parë: pas informatavet që merr nga një njeri në Levkadhë.

Në funt të shekëllit të tetëmbëdhjetë, në vitet 1781 gjer më 1798, gjendësh në Korfuz, në Zantë dhe gjetkë, si konsul i Francësë, i quaj-turi André-Grasset Saint Sauveur Jeune i cili, më 1800 (motin VIII të republikësë) botoj një librë me tre volume: *Voyages historique, littéraire et pittoresque dans les Isles et Possessions ci-devant Venitiennes du Levant; savoir: Corfou, Paxo, Bucintrò, Parga, Prévéza, Vonizza, Sainte Maure, Thiaqui, Cephalonie, Zante, Strophades, Cerigo et Cerigotte*.

Kur shkronj këtë artikull mjerisht nuk' e kam pranë, veprën e më-siprëme, dhe shtrëngohem të shërbehem prej përkthimit të saj gjermanisht, shtypurë më 1801 në Weimar, në një të vetëm volum: përkthë-njësi, thotë vetë në parëthënëje, disa pjesë të librës' i ka shkurtuarë . .

Përshkrimet e Shqipërisë fillojnë (faqe 136-159) me atë të Bucin-tro-jt, Vuthrozon, Buthrotum i vjetër, Vutrino e sotme, që e quan me peshk të shijshim, me gjah të shumë (derra dhe sorkadhe), po me ethe më të teprë akoma.

Pas Vutrinos konsuli i Francës flet për Pargën „në lindje lindje-veri të nisisë Pakso, mbi zallin perëndimor të Shqipërisë, është Parga“, vënt i bukur, me klimë të mirë dhe banorë të shëndoshë, tokë pëllore në drithë, verë, vaj, portokalle, me gjuhë shpendi të shumë. Popullsi e qytetit është afró 4000 frymë.

„Gjer ne paqa e Passarovic it, më 1718, nërmiet Tyrqisë dhe Venetikut, Parga ishte e Shqipërisë; në datët që përmëntmë shkon Parga për herën' e parë në pronjë të Venetikut; pozita e saj ka një rëndësi të madhe për të ndaluarë operatat e anmikut në Shqipëri . . . Është një skelë ngaha eksportohetë prodhimi i shqipëtarëvet, me të cilët shpesh herë garnizona veneciane gjendetë në zihje . . .

„Karakterit i banorëvet të Pargësë ka krenari dhe barbarin' e Shqipëtarëvet. Gratë kanë liri të plotë. Po një grua së cilës i thuhetë një galanteri që s' i pëlqen, nukë pret shpagën e të shoqt: një gur, një

thikë, ose ç' t' i bierë në dorë, jan' armë jo të kota për të Petkat e burravet, si edhe vetijat dhe zakonet e tyre janë ató të Shqipëtarëvet . . .

„Nga Parga, duke ndjekurë bregun e Shqipërisë, arrijmë në mëngë të Nartësë, ku është Preveza . . . Afrimi i malevet të Shqipërisë mbuluarë me vborë, dhe moçalësi e mëngës' së Nartësë, e bëjnë Prevezën të ketë një klimë të keqe.

„Toka e Prevezësë ka qënë fort pyllore, me drurë të mëdhenj; Venecianët e kishin ndaluarë që të pritenë këta lisa, dhe secilin e kishin shënuarë me markën e Shënt Markut; vëndësit ca nga ca i prenë drurët dhe çelnë arra; po, me qënë se dheu është pak' i volitshmë për drithë, zunë banorët të mbillinin ullinj dhe u-pa se ky drú jep shumë fitime; të mbiellët e ullinjvet bëhetë në prill ose në maj, duke marrë një drú ulliri një këmb' e giysmë të naltë: i këputin gjethin, e shartojnë dhe sakaqë e shtien në tokë, e mbulojnë me dhë..

„Kur Preveza shkoj në duart e Venetikut, pas paqës së Pasarovicit, qyteti i sotmë ishte një katund me 60 kasolle kashte me dy ose tri shtëpi më të mira. Paqa dhe tregëtija ngjallë një qytet të formuarë më tepër prej Grekësh refugjiatë.. Venecianët kishin në këtë qytet dy detashamente grekër, prej 24 vetash... Po, kur e menasonin qytetin Shqipëtarët, atëhere proveditori sillte forcë ushtarësh italianë dhe skllavonë, nga Aja Mavra.

„Nga karakteri dhe vetijatë Prevezanët ngjajnë me fqinjët e tyre; nga këta mernin dhe shumë fjalë për gjuhën e tyre, e cila është greqishtja. Të mveshurët e tyre është pothua krejt shqiptare. Shqiptarët qënë edhe themelonjësit e parë të këtij vëndi, dhe kanë ruajturë, me gjithë këmbimin e sunuësit të tyre, tër ata zakone dhe prieri... Pozita e Prevezësë mbi bregun e Shqipërisë e bënte fort të volitëshme për tregëti; po Venetiku s' ka diturë të ndiekë një politikë të mirë.“

Më poshtë autori na rrëfen se tregëti e Francësë me Shqipërinë bëhësh më tepër për lëndë pylli që kishte nevojë arsenalit i Tulonit; kjo tregëti bëhësh në fillim me ndërmietësin e tregtarëve grekër që lëshnin pazar me Ministrin' e Marinësë; tregëtarët kishin zgjedhur Durrësin si qendër të tyre; po, pa shkuarë shumë u duallë konkurentë, të cilët zunë të shpienë drutë në Napoli dhe në Malltë; kjo e ngriti çmimin e lëndësë si dhe taksa që mirnin pashallarët e ndryshmë, në vëndet e të cilëvev ndodhësh pylli; m' anë tjetër edhe ruajtësit që pagonin tregëtarët i shtonin spenzimetë; në funt, duke u-prerë pyjet e bregut të detit, u-bë fort e rëndë dhe e kushtushme që të eksploatohen drurët brënda në stere, dhe, ca nga ca u-fik kjo tregëti.

I quejturi Lasalle, një tregëtar i math i Marseille-s, desh të ngjallte prapë këtë tregëti kaq importante me Shqipërinë, dhe më 1784 er-

dhi zgjodhi Prevezën si qendër; filloj miqësi me Pashan e Janinësë, Ali-në; dhe zuri një tregëti të madhe dhe të fitimshme, po, më 1792 në gusht, u vra pranë shtëpis' së tij në Prevezë, padyshim prej Venecianëve, dhe kështu pa shkuarë shumë, u-shduk ajo interprizë.

Voyage en Morée, à Constantinople, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l'empire Othoman, pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801 par F. C. H. L. Pouqueville. Paris 1805. 3 volyme.

Pouqueville-i që më vonë do të njihete më mirë Shqipërinë dhe do të na jipte një veprë të gjerë dhe të madhe mbi të, ka shkruarë këtë libër të parë të tij mbi orientin në një mënyrë që munt t'a quanjë vërdhuni, pa dashkë, me qënë se këta vënde i ka njohurë si skllaf, i zënë në det prej barbareskëve, prej një korseri të Tarabulluzit, dhe më vonë prizoner në duart' e Tyrqyvet

Autori është mjek dhe është dërguarë në Misir për te shokëruarë komisionin për shkenca dhe arte; si u-sëmur në zall të Nilit u-shtrëngua të kthehet, dhe udhëtonte në një anije bashkë me disa oficerë francezë, kur e zunë korserët afër Kalabrisë: kryetari i hajdutëve të detit ishte një Shqipëtar, i quajtur Orush, nga Ulqini, qytet për banorët e të cilët Pouqueville-i thotë se mirrem shumë me kusëri dhe hyjnë në shërbim të harbarekëve. Me të u-zunë skllaf edhe shokët e tij, po fati e dashi që autori ynë të ndahetë prej shokëve të cilët i morri Orushi me vetëhe: vetë mbeti në anijet me të cilët kishte udhëtuarë nga Misiri, po me tajfë dhe kapiten kusarë. Kjo anije e nxier në Navarin, s' andejmi shpihet në Tripolicë, ku shkon tër dimërin, si prizoner në duart' e Tyrqyvet, me qënë se, midis Tyrqi dhe Francësë ishte deklaruarë luftë, po në një liri relative, të detyruarë zanatit të mjekesisë Volymi i parë i veprësë që analizojmë është mbushurë me përshkrimin e Moresë, do të intinerarit që ka bërë vetë, do m'bas informatatet të mbledhura mbi rrëfeniat e njerëzvet me të cilët kuvëndonte.

Nga Moreja Pouqueville-i u çua në Stamboll, me një anije nënë komandën e një Spec'oti, dhe në kryeqytet të Tyrqisë qëndron 25 muaj mbyllurë në të famshmet J-dikule (të Shtatë Kulatë): volym i dytë është konsakruar i tërë në përshkrimi i Stambollit.

Nga Stambolli autori ynë kthehet në Francë dhe prodhimi i literaturësë dhe i erudicionit të tij do të kishte formuarë vetëm dy voly-më, sikur të mos kishte gjetur anën të na japë dhe një volym të tretë-fieshtë mbi Shqipërinë, të shkruarë mbi rrëfimet e dhënë prej tre shokëve të tij, të zënë prej Orushit dhe mbetur në anijet të tij.

Oficerët Poitevin, Charbonnel dhe Bessières, u-shpunë prej Orushit në Vutrinto ku gjendësh Ali Pashë Janina me një fuqi të voglë të tij:

të tre Francësët shkojnë nga duart e korsierit Ulqinak në pushtetë të vezirit të Janinësë, ku u-gjelnë pa dyshim më të lumturë, dhe Charbonnel-i u-bë kolonel i kanonierëvet

Pouqueville-i ka mbushurë të treqint faqet e volymit të fundit me përshkrimin që i kanë dhënë miqt' e tij, jo vetëm të Shqipërisë së jugësë, po edhe të asaj të veriut, me qënë se, të tre oficerët, pasi ndënjtë në dorë të Ali pashësë, dhe deshnë që të shpëtojnë duke ikur në Korfuz, u-çuan në Stamboll, dhe s' andejmi bënë një udhëtim prej stereje gjer në Shkodrë.

Sikundër që e thotë edhe vetë në parëthënjet të tij, Pouqueville-i është i pari që ka dhënë një veprë deskriptive, të bazuarë mbi dëshmin e njerëzvet që kanë muudurë të observojnë me seriozi vëndin tënë ku ndënjtë afëro tre vjet. Sikur autori të kishte qënë vetë udhëtar në Shqipëri, s' ka dyshim se libra e tij do të kishte një interes fort më të math për neve.

Vetë mjeku që do të bëhesh më vonë konsul pran Ali pashësë, flet disa herë në volym të parë të librësë, përmbi shqipëtarët pas njohjësë që ka bërë-syresh në kohët që ndënj në Morë.

Volymi i tretë fillon me një përshkrim historik të Epirit, prej Barbé du Bocage, gjeograf'i ministris' së punëvet të jashtme. Pastaj nis histori' e oficerëvet, dalja e tyre në Vutrinto dhe piekja me Ali pashën. Shqipëtarët vizatohenë me ngjyra të mira, pa atë smir dhe urrejtje që autori do të rrëfente në veprat të tij të më pastajme: i rrëfen trima, gazmorë, të gjallë, dhe një legjendë nër tã i bënë të besojnë se janë fis me Francesët (faqe 21), dhe vetëm ata në hall dekadence që gjëndet imperatorija Ottomane kanë ruajtur karakterin e tyre krenar dhe luftar.

Pas këtyre shënimeve fillon udhëtimi dhe përshkrimi i vëndit: Delvinë, Sarandë, Janinë... duke shkuarë flet mbi karakterin e Ali pashës, që s' është i keq për qejf, po vetëm kur e lyp interesi i tij (faqe 41) dhe na rrëfen se, në Bonillë, në katund afër Janinësë ku ka një pallat të voglë, Ali u ka siellë dhe vendosurë Bullgarë, duke u-kthyer nga luftët kundra Pasvanogllu-jt (faqe 48). Më poshtë rrëfhetë udhëtim i Bessières-it me Ali pashën, në Tepelenë; rrëfimet mbi vëndin janë të shkurtër, pa caktim, dhe teprë duke përmëndurë do emra historikë; për Himarën dhe qytetet e Çamërisë: Filat, Pargë, Frar, Gumenicë, Paramithi, Sul, Prevezë; ngjarja e Prevezësë (funt i motit 1898) dhe marja e saj prej Francesëvet ka një interes më të vërtetë si një send' të rrëfyerë prej një njeriu që e ka parë me syt' e tij.

Luftët e fundit të Sulit (1803) mbushin një kaptinë të librësë, dhe këtú këtje autori flet për dashurin e independencësë që kanë shqipëtarët, dhe sa vështirë do të jetë të hyjë nënë një sunim të huaj ky popull, të cilin nuk e trëmp kurrjë ditën që mpron lirin' e tij.

Po, një kaptin' e tërë (kaptina XVII faqe 149) është shogruar ne vetitja e Shqipëtarëve, dhe jep këtë tablo të fizikut dhe moralit të tyre:

„Shqipëtarin ndryshon nga Greku... shtati i tij është pesë këmbë katër puse (një metro e shtatëdhjetë e një santimetro); janë të muskluarë, këndin faqor përgjithësisht të drejtë, fytyrënë në formë veje të zgjaturë, faqetë me gjyrë, syri i shkëlqyerë, goja e proporcionuarë, dhëmbët të mirë; ballët e ka të ngushtë, qafën të gjatë, krahorin të gjerë dhe të mbuluarë me pakë qime; s' janë të ngjallurë, shtatin e kanë të bukurë, janë të shpejtë dhe të shkâthët, kërcënjtë të hollë, pulpat pa mish.... barkunë s' e kanë të math dhe trupi i tyre është bërë për ecjet e gjata.

„Shqipëtarin e gjen njeriu mbi gjithë pikat e imperatorisë, dhe, që nga Frati e gjer ke Drini, në Misir, në Tonus dhe Xhezair, Arnautët ose Shqipëtarët, janë më të mirët e ushtarëve, milicianët më të famëshëmë.... Gratë që piellin të tillë njerës, janë edhe ató të shëndosha si atá... rrinë më teprë kohë se nga Greketë të ra dhe të bukura...

„Përveç trimërisë që është në naturë tij, Shqipëtarët kanë dhe një karakter franshize, të panjohur ne popujt e lindjesë. Nuk' e mshehinë mendimin e tyre dhe e dëftojnë çiltazi në estimojnë ose në përbuzin njerinë....

„Vëndin e tyre e duanë me entuziazmë; kur flasinë sijshe e vënë mbi vëndet e tjerë, dhe, sadoqë të rrojnë në vise më të mirë dhe më të lumturë, vështimi i tyre vete kurdoherë ne malet e Epirit. Nuk kujtojnë moskamjenë, rreziketë; po independencën e tyre; nukë munt të harojnë kasollen' në të cilët kanë lindur, shkëmbënjtë ku brithnis, luginën që pa djalërin' e tyre....

„Pse të jem i shtrënguarë të përzjenj këtú dhe qërtimin për sielljet e tyre kundër moralit? Duketë se prierit e turpshme që janë të shëmtuara dhe prej natyrës së njeriut, lindin nga barbarizma.... mbase jeta në ushtëroret dhe rrojta e tyre brëdhëse i enkurajon këta pasione brutale....

„Grekët që rrojnë midis Shqipëtarëve kanë vetija më krenare se ató të Grekvet të nisivet të Moresë, dhe Greqisë në stere: nuk' u ngjajnë atyreve, dhe nuk janë as dinakë, as falshë, as edhe shkaravitën, nënë të rahurit e Tyrkut.

„Do të mbaroj duke thënë se, Shqipëtarët, tekdo që të jenë, gjendenë të bashkuarë dhe formojnë një trup të veçantë krenar me emrin e tij; ruajnë me këmbëngulje gjuhën e tyre dhe mbetenë, me gjithë mërgimin, kurdoherë Shqipëtarë dhe madhështorë prej këti emri.“

Në kaptinë më të parë, në faqe 145, Pouqueville-i na kishte thënë, duke shënuarë kufit' e Aliut të Janinësëi „Ky është vëndi që sunón. Në qoftë se polhuai tërë ky vënt është akoma barbar, me gjithë këtë

dubetë, shënuarë se Shqipëria është copa e imperatorisë më e bëgaçme në njerës trima dhe luftarë, dhe në prodhime toke. Shqipëtarët janë ushtarët e Aleksandrit të math dhe të Gjergj Kastriotit....

Edhe këtë kufi autori Frances i zgjat në jugë gjer në Akarnani, atëhere Karleli, për të cilën thotë që „është një kanton i vogël i Shqipërisë Jugore“.

Po, histori e Francesëvet në Shqipëri përnjëherë pritetë dhe banorët e përdhuni të vëndit t'ënë evadohenë dhe ikin në Korfuz, ku i pret një arrestim i dytë nga ana e autoriteteveve rusë; këtë radhë më nuk i dorëzohenë Ali pashë Janinës, që i reklamonte me insistencë, po Turqisë vetë, dhe çohen në Stamboll. Në Stamboll të tre oficerët s' do të rrinin shumë dhe nisenë për të bërë një udhëtim të gjatë prej toke, udhëtim në të cilët kanë rasje të shëtitin dhe të shohin edhe pjesën e veriore të Shqipërisë.

Nga zalli i Bosforit, me anë të Bullgarisë, udhëtarët arrijnë në Kumanovë, Ysqyp, Kalkkandelen, vise që përsbhkruhenë, dhe më tepër pjesa e fundit, si fort pak' e popullsuarë dhe e varfrë. Nga Kalkkandeleni, duke shkuarë Sharin, arritnë në Prizren, me shumë mundime, në malt me vdori: disa udhëtarë ndjenë atë që quhetë smundja a malevet, u erdhi gjak nga hunda, mezi ecnin, i zuri gjumi. Ishte stinë parvere, mars, dhe akoma askush s' kishte kapërxyerë malin e lartë.

Nga Prizreni do venin në Shkodrë, tridhjet' or' udhë, në një vënd të shkretë dhe të egrë, pa katunde. Karvani është i shtrënguarë të marrë me vetëhe, jo vetëm hejë për njerzit po edhe tagji për kuajtë; udha është e keqe, në male të lartë, shtigje në mes të shkëmbënjet, të thelluarë prej ujrvet të shiut, këtú atje me pyll bredhi. Njerzët e këti vëndi rrëfeshetë si hajdute dhe e egrë, e përndarë në shtëpi të largëta njëra prej tjetrës, pa një formë grumbullimi që bën pshatin e njerëzvet të qytetëruarë.

Të tretën ditë, kur arrijnë pra në fushë të Shkodrësë, udhëtarët e lodhurë prej gjashë-nibëdhjet dit' udhe që nga Stambolli, pandehin se po shohin një copë të parajsësë, me kopshtet, pemët, vreshtat e saj dhe pëllorësin' e jashtëzakonëshme, një fushë, thot autori „nga më të bukurat dhe më të bëgaçmet të dheut, prej pëllorësisë, me ullishta dhe vëneshtatë. Në këtë fushë janë një tok katunde me shtëpi të izoluar, dhe njerëzija e këti vëndi të bukurë gëzojnë paqën, shëndetin dhe një rroitje simple, në kamje dhe pasuni“.

Shkodra atëhere gjendesh nënë sunimin të Ibrahim pashësë, i cili i priti me miqësi të madhe, i bujti në konak të tij dhe kështu u-çlodhë dy ditë.

Kjo veprë e mjekut Francës ka për neve vleftën të jet' e para libër në të citët jepetë një përshkrim i vëndit dhe një rrëfim për ngjarjet e tij; fakti që nuk është shkruarë prej udhëtarëve që kanë parë vëndin, po vetëm mbi dëftyerët e këtyre, prej një njeriu të tretë, e bën që të mos ketë asnjë përshkrim me hollësi, të kënaqetë me një vizatim të zbetë.

Disa dorëshkrime shqip me germa tyrqishte

Besojmë se në Shqipëri do të ketë mjaft shkrime me germa tyrqishte, të shpëtuarë prej duhivet të ndryshme. Sa pa u-çdukur krejt, do të ishte mirë sikur të kujdesohëshim dhe t' i mështuellim, t' i kopiojmë në formët origjinale të tyre dhe duke i transkriptuarë

Këndónjësvet të mij u lutem që t' i vënë re kësaj pike dhe do të jem fort i lumtur në më komunikofshin zbulimet dhe vërejjet e tyre.

Në numur të parë, faqe 5 të kësaj reviste, bënim fjalë për katër shkrime të Hafëz Ali Ulqinit, të cilët s' i kishim parë. Z Hamdi Bushati pati m'ësinë të më siellë nga Leshi, ku ruhenë prej birit të ndyerit H. Ali, copat e para të tre dorëshkrimeve, dhe më ndihmoj në këndim të tyre.

I pari ka një format 18 × 23 santimetro, shkruarë bukur, pastrë dhe me dorë të Hafës Aliut; fillon me afëro pësë faqe një parëthënë, e arabishte, që po e përkthejmë më poshtë; pastaj vijnë afëro katër faqe tyrqishte në të cilat autori shpiegon alfabetin tyrqisht që ka adoptuarë për gjuhënë shqipe, dhe pas asaj vjen alfabeti vetë, që ka mbuluarë dy faqe e gjysmë.

Lënda vetë e librësë fillon në verso të fletës së shtattë, me titullin *Bedi-yl-mukattar*: është një mbledhje fjalësh dhe frazash tyrqishte të përkthyer shqip, e bërë me vjersha, me masë dhe kadencën që njihet në gjuhët orientale me quajtjen fa 'latyn, mefa 'ilyn, myfte 'ilyn... Dorëshkrimi ka 191 faqe.

Në këtu përkthimi, pakë shkurtuarë në funt, e parëthënjes arabishte:

„Gjuha shqipe ka mbetur e pa shkruarë dhe e pa përdorurë, dhe kështu, duke mos u-quajturë fare gjë, dukësh si e ngrirë dh' e vdekur midis gjuhëve të tjera. Nuk i gjenj kësaj gjuhe no një të metë veç se kishte nevojë për ca shkronja dhe shënja. Shumë veta, dhe veçanërisht

gra dhe kalamanjtë, i kam parë se jan' n' errësirë dhe s' kupëtojnë ç' u lipsetë, nga shkaku se nukë marrin vesh tyrqishtenë, dhe aqë më tepr' a-arabishtenë, veç se dëgjojnë disa vjersha, me masë dhe rimë, ose disa fjalë. Kështu u-shtrënguash që të përkthenj mevludin e pejgamberit: kjo ugjau kur isha në moshë të djalërisë; në mot 1290 u-mbarua, me lehtësinë që më dha Zoti fuqiptotë, mbreti i mbretërvet dhe dituri-math. Pastaj koha më shtyri, si qe shkruarë prej Zotit, qoft' i pastrë dhe i naltë, të ndahem nga vëndi im, nga Ulqini dhe të vetë në Shkodrë: më 1296. Disa miq që panë mevludin, kërkuanë që të përkthenj në vjersha mesimet të quajturë Hoda rabbim, të Ibrahim Hakkiut, bashkë me disa ngjarje dhe çashtje. E pranova urdhërin e naltë të tyre, i përktheva dhe i mëshollta në një volym : viti më 1298. Edhe si u-shtyp morri famë në këtë qytet edhe në qytetet e tjerë, me lejën e Ministris' s' Arë-simit, moti 1302.

„E gjeçë se, për Shqipëtarët, me tyrqishtenë, që është e lehtë dhe e vargënuashme, munt të arrihetë qëllimi dhe dëshira e mësimi; po, takova disa nshanës nismëtorë që s' e kupëtonin mirë atë gjuhë, duke pasurë nevojë për një fjalor me shqipenë. Sa munda fillova të vjershëronj tyrqisht duke i përkthyerë shqip, që të lehtësonj kuptimin; moti ishte 1315; atje mbloodha fjalët dhe nyjet që u duhenë për të folurë, sadoqë nuk është e mundurë t' i mëshitiellë njeriu të gjitha. Ndoshta të kem lënë edhe shumë fjalë, po, me gjithë këtë, cili dëshëron të mësojë tyrqishtenë prej shqipesë, mundet të bëjë një krahasim. Shpresohetë se munt të ketë edhe një tyrk që të dojë të nxërë shqipe, edhe e quajta *Bedi-yl mukattar*. Si e mbarova, u-mentova dhe e pashë se nuk e plotëson qëllimin, nga shkaku se nukë gjen dot, ay që dëshëron, një fjalë nga tyrqishtja në shqipet. Pra, disa prej miqvet më urdhëruanë të bënj një fjalor tjetër, duke e radhiturë pas shkronjavet të abecesë, që kësisoj të lehtësonetë kuptimi: unë, sa-dogë s' e pashë vetëhenë të zoti për këtë gjë, e pranova urdhërin e tyre, se, përulia përpara dëshirës së të mëdhenjet është një prej nevojavet të edukatësë, edhe atá që përulenë jan' në syt të mëshirës' së Zotit Porse gabuanë duke mejtuarë që unë jam i zoti, kur se kapitali im është fort i pakët, edhe nga pandehme e tyre unë jam fare lark; desha vetëm që t' i bindem urdhërit, edhe me gjithë që thashë se, i urdhënuami nuk është më i ditun se urdhënuami, fillova me ndihmën e ati që jep sukses për plotësim... Emnin ja ngjita *Axhib-yl-menzar*.... pastaj bëra një tjetër libër nga shqipeja në tyrqishtet, të cilën e quajta *Garib-yl-mebzar*; të parën në një libër, të dytën në tri, dhe të trija bashkë i quajta *Ulqin*, dhe kjo në kohë të sulltan Reshadit...”

Tani po japim edhe faqen e parë e *Bedi-yl-Mukattarit*:

Allaha hamd Zotit shyqyr, lëvdim *sena, derler* i thon,
Mahsus shyqyri, sana ty, ja rabbena ej Zoti jon,
verdi i dha, insana nir, dil gjuh, besar. t' pam, sem'nigjim,
ni' metleri sajmak me njeft, *jokdër nihajet* s' kan marim
hakkën selami perenis, qoft *olla, gjithëmon daima*
oll Ahmedi paqyzre përmi at Muhammed Mustafa
 i zot' turqënis
ondan byjyq më i madh se aj, *halk ollmamish* s' është jeretis,
pes mesanej, as-hable al ollsun selamllar qoft selam,
allah zotyn, sulltanena mretit, ymr *ihsan i dhasht,*
bir gjyni nji dit, *bin* nji mi, *hak ejlesyn* Zoti ja baft
Hak hifz edé Zoti e rrujt, shen zemra *mesruryl-juad*
peq çok jasha fort shum rruoft, *mev' el myluq Mehmed Reshad*
mystef 'i lyn, bu bahre vezyn terezi
 çikdi i doll' tarihi menzumei arnaudi
 1042 273

Po jap këtë një pjesë nga *copa* e fundit e broshurës që kam në dorë, nga fleta 11:

gjylmeq me qesh, *aghillamak* me qá, *aramak* me kërku, *jatmak* me ra,
jyr ec, otur rri, *durmak* me nenj, *gjör shif,* shiqá, kqyr, *gjörmeq* me pá,
bakënez shiqoni, *gjelel m* pa vím, *durunuz* naloni, *koshmak* me ngá,
japdëm e bava *japajim* e banj, *japdëk* e bamë, *japmak* me ba,
japmish e ka bá, *japaxhak* e ban, *jërtedëm* e grisa, *jarmak* me ça;
çardëm e thira, *çarmak* me thir, *barmak* me bërtit, *sesle* me zâ,
hasta dejildër nuk isht i lik, *bash aghrësë var* dhim kreje ka,
sövdym e shava, *sövdyk* e sham, *sövdyn* e shave, *sövmeq* me sha
atdëm e hodha, *atdi* e hadh, *asdëm* e vorra, *kurudu* u-tha,
jëkadëm e lava, *jëkadë* e lau, *jëkadëk* e lamë, *jëkamak* me la,
verexheqmi a jep, *verërëm* e jap, *verelëm* t'a japim, *karzan* uha...

Dorëshkrimi i dytë i Hafëz Aliut është gjithë në formatin e të parit, 18 × 23 santimetro, dhe i cili më thonë se ka 435 faqe; autori e ka titulluarë *Axhib-yl-Menzar*; çdo faqe është ndarë në dy shtylla, dhe çdo shtyllë prapë e ndarë me një vijë të hollë: në të parët është fjala tyraqisht, dhe në të dytët kuptimi i saj shqip; çdo faqe ka 22 gjer më 25 radhë, kështu që mban 44 gjer më 50 fjalë.

Po transkriptojmë këtë të dy faqet e para të librësë :

TYRQISHT	SHQIP	TYRQISHT	SHQIP
A	çud	ab	uj
A bumidir	çud a ky isht ¹	abad	shen

¹ të vërehetë forma *isht* e verbit të qënë, që përdor Ulqini.

TYRQISHT	SHQIP	TYRQISHT	SHQIP
abad	gadí ²	apazllamak	me ec barka pupo
abamak	me i prit	apazllamak	me bodërhú
abandërmak	me i u nalú	apansëz	në trëshím
abanllamak	me hap hapin	apallak	çilímí.
abanmak	me i zavorrit	apallak	kalamá
abanmak	me i kcy cipri	apësh	tul koshe
abanoz	kulumrí	apshak	shapullak
abeni	sharavet	apshuk	prituc
abdar	njom	apëshdërmak	me lodh shtancën
abdar	ujc	apëshdërmak	me armëzhú barkën
abdall	budall	apëshmak	me met krra
abdallëk	budallí	apëshëk	malís [molí:]
abdest	uj dursh	apuk sapuk sôjler	korr e mas lidh flet
abrash	pedinaç	apull	llapash [llapaç]
abru	uj ftyre	apiko	kacavar
agha bej	ap ³	at	kal; hidh-e; qit
ab gjine	poç	ata	bab; tat; át
ablla	tad ⁴	atak	qitun
ablak	ftyre mushun	atak	hiedhun
ablloka	rethú	atakllek	përhiedhun
abli	skot	atan	yt át, baba jat
aburxhubur	çalapin	atana	t' yt ét, babës tan
abuk sabuk	korr e mas lidh ⁵	atanë	t' t' at, babën tan
abona	përpara, peshin	atallar	baba
abjarí	me lag	atallarë	babat
abjarí	unim	atam	em at, baba jem
ap	fart ⁶	atama	t'im ét, babës t'em
ap ak	fart bardh	ataja	babës
aparmak	me i pesú	atdërmak	me i bá me qit
aparmak	me i grabit	atdërmak	me i bá me hiedh
apaz	grusht	aterina ⁷	cumr
apaz bughdaj	një grusht grun	atesh	zjerm
apaz	pupo	atesh byxheji	xhixhllonj

² godí³ fjalë tyrqishte, shkurtim i *aghabej*, vëlla i math.⁴ ? motr⁷ e madhe.⁵ që nuk di që thotë.⁶ fort; autori shpesh përdor *a* në vënt të *o*: gadí, mas (godí, mos)...⁷ *kamus tyrqí* fjalës aterina i jep kështú kuptimin: një farë peshku, merxhan ballëk, i math.

TYRQISHT	SHQIP	TYRQISHT	SHQIP
ateshpare	gac ⁸	ateshzeban	therc
ateshpare	shkuní	ateshgjözý	gac zjarmit
ateshperest	taptisun zjarmit	ateshler	zjarminje
ateshçi	zjermur	ateshlik	votr
ateshzeban	gjuh zjerm	ateshlendirmeq	me i dhan zjerm

Dorëshkrimi i tretë është gjithë n'atë format dhe me atë shkrim të pastrë si edhe dy të parët; çdo faqe është ndarë, si edhe i pari, në dy shtylla, dhe çdo shtyllë në dy pjesë; faqetë kanë 21-23 radhë, dhe janë, pas informatavet që më jipte z. Hafëz Said, 133 faqe. Titullin e ka *Garib-yl-Mebsar*.

Të dy faqet e para mbajnë këto fjalë :

SHQIP	TYRQISHT	SHQIP	TYRQISHT
a	ö,lemi	atjë	orada
abarr ¹	avlli	axh	amuxha
abarra	avllëllar	axha	amuxhallar
abard ²	jyryjysh	axharr	kallaballëk
abie ³	kapún	ad	adá
abica ³	kapunllar	ar	klaptan
ap	a' bej	ar	tarllá
apan ⁴	çarëk	arç [?]	qevezit [?]
apana ⁴	carëkllar	ardh	gjelish
apet	prap	ardhun	jakëshëk
aposta	mahsus	ardhí	asmá
apifa[?]	sallpa[?]	ardhí rrushit	yzym asma
apín	çarëk	ardhija	asmallar
apína	çarëkllar	ariz	pirinç
atë	ata, peder	arsý	xhevap
atá	onllar	argun [?]	byxhyrgat [?]
atypari ⁵	orallë	ark	sandëk
atyne	onllara	arkec	tarem tak
até	onu	arm	silah
atí	oná	armatís	silahllanma

⁸ me kall, me kath, të ndezur; kallës, kadhës, gac: që ndez, një copë zjar.

¹ Shënuam' më lart përdorimin e *a* në të *o*; pra *abarr*: obor; më poshtë edhe autori shkron *aborra*.

² ? tyrqishtja ka kuptimin: ecje.

³ as shqipeja, as tyrqishtja nuk' kupëtohetë

⁴ do me thënë: *opanga*, *opinga*.

⁵ në folje të Shkodrës *atypari* do të thotë nga ajo anë.

SHQIP	TYRQISHT		
armaç	jértmaç	ashtu isht	øjledër
armuz [?]	sokra [?]	ashkëll	jonga
armish	armador	ashklla	jongallar
arn	jama	ashik	bixhil
arna	jamallar	agzat	jemliq
arním	jamallëk	agiç	qysmen
arnumun	jamanmësh	afër	jakën
ariz	pirinç	afró	janash
arr	xheviz	afiq	llagap
arra	xhevizler	a ka	varmi?
arrç	qevazit	akull	buz
a rri	otururmu	akoma	dahá
a rri	otururmujum	anþh	basan; qabus
a rrihet	oturullurmu	anc	belbel
asaj	ona	anër	ru'ja
aspak	hiç	anej	öté
ashpër	sert	alka	kajmak
âsht	qemiq	allagrap	akën
ashtú	øjle	ám	mexhra



Përveç këtyre tre dorëshkrimeve të Hafëz Aliut, në Shkodrë gjenden edhe disa shkrime shqip të tjerë, të mbeturë nga kohë të ndryshme, dhe prej të cilëve Z. Shevqet Muka pati mirësinë të më bjerë katër copë, të gjithë të shkruarë me germa tyrqishte.

Tefteri i parë është në format të vogël, me 12 fletë do me thënë 22 faqe, në vjersha: është ajo librë fetare që quhet *Emni Vehbié*, shkruarë prej Tahir efendi Jakovës, i njohurë me emër Tahir efendi i math. Në funt të faqesë 21 këndojmë këtó radhë:

„Seneja nji mij e dy qint e njizet e nji
„tamam u-bë Vehbie, kur Zoti má dha hodie“

Libra e dytë ka një format 15,5 × 20 santimetro, dhe mban 190 faqe; autori i saj është Mulla Ramadan Shkodra, i njohurë me emër Mulla Rama, hoxhë në Postripë. Tefteri është ndarë në disa pjesë:

6 faqe në krye, në vjershë, janë *Ilm-i-hal*, të cilat i vazhdojnë katër faqe prozë, edhe kështú, herë me vjershë dhe herë me prozë vete gjer në faqe 73.

Pjesa e dytë quhetë *Risale-i-Sufie*, në vjershë, nga faqe 74 gjer më 86.

Vijnë pastaj 9 faqe në prozë, një landë fetare dhe këtë i pason pjesa e madhe në vjershë, e quajturë *Nasihât-yd-din fi hifz-il-lisan*, pjesë që vete gjer në funt të teferit, me tri ilahi në mbarim.

Transkriptojmë këtë copën e parë të kësaj pjese së madhe, faqetë 96, 97, 98 të teferit :

Bismil-lahi une po tham,
 me fol qitabin nrim të kam;
 ëlhamdy lil-lahi po tham
 qi më ke fal ehli islam,
 me ke falun me din e iman;
 ibadet baj un Zotit t'an
 shyqyr me të bamun gjithkú mmar
 nuk di ku filloj mâ par:
 me fillú në kry ç' ka jan
 shyqyrin s' munt t' a baj taman;
 johsë a'zadeve të tán
 po 'ni' meteve qi m' ke dhan!
 Gjithkun une i mangut jam
 veç ti, ej Zot, qi je tamam
 me sifate tamam ti je
 pej t' mangunash mynezzehe je.
 Për me t' qen dú me diftú
 tok e qiellna i ke rreshtú
 une e di, ej Zot, qi je nji
 përpara njihit s' ásht kurnji
 as ka venn Zoti mí qillna,
 as ka n' tok, kshtu e dim na.
 Nuk ash nji senn sikur Zoti
 delile jan edhe me mij,
 ajetit veni mennen ti:
 të tham: Lejse qemithlihi.
 Sikur se duhet me e diftú
 nuk' ásht mymqyn për me kallxú
 këtë alamete qi ka dhan
 turk e bull për me i prú iman.

Për të dhënë një kuptim nga *ilm-i-hali* po japim edhe prej atij **katrë** vjersha qitun nga faqeja 27 :

Hem shehadetin n'e pâr e der n' e mram
 me than me goj, me zembr, xen bes tamam;

edhe ma' nan shehadetit për m' e xan
kush të jet turk edhe bull* farz e kan

Në faqe 55 dhe 183 të dorëshkrimit këndojmë këto dy copë që rrëfejnë influencën e Tahir efendi Jakovës dhe në sa respekt të math ka qënë në Shkodrë, sikundër që përmendet edhe Haxhi Hasan efendiu që paska kënduarë shqip hytbenë :

„Tahir efendis borxh e kena me i bá dua fort. Pernija e past bâ ehli xhennet, në derexhe të nalt. Edhe kusuret já falt, pak a shum në past, qi e vuri shqiptoren në kalem. Gjithkush e flet, plak e i ri, dinin edhe imanin po merr vesht“.

„Zotí já falt Tahir efendis gjynahet e tij, edhe i dhashtë rahmet me miluj edhe me mij, qi na bani shqipen ixhad me kalem, e po xen plak e i ri; edhe past rahmet sa raná n' det nj' aj qi rri n' xhamí të Kara Hasan, qi emnit i thon elhaxhi Hasan efendi, qi na forcoj dinin shqip në hytbe, hem kudó qi po rri. Edhe Zoti e falt q' at hoxh katunsh, hem gjá s' di, se ka gjynahë qi s' i xan kál, as qerr, as gjemí. edhe mâ shum sè ka deti ran, e në dynja bar e gjeth. I mjeri i bâj rixha hallkut m' ket zeman nji el-hamd të má kënoni; johsa bari pa nji rahmet mos të m' leni.

Bashkë me këta dy dorëshkrime, më prunë nga Shkodra edhe tre të tjerë; po këta ishinë vetëm kopie të copëvet të Mulla Ramës, dhe kësh-tú nukë peraqitin për neve no një gjë të re.



Këndonjësit t' an' e mbajnë mënt se thamë që në Shqipëri këndonë prej bektashinjvet dy libra të vjershëruara, njëra prej Dalib bej Frashërit, dhe tjetra prej Shahin bej Frashërrit, e para me emrin Hadi-ka, e dyta e titulluarë Muhtarname.

Hadikaja është një përkthim nga libra e Fuzulit, dhe më thonë se qënkësh shqipëruarë më 1235, afëro më 1820, me datën t' ënë; gjën-detë so: në disa teqé, dhe z. Rexhep Sefo Frashëri pati mirësinë të më dër-gojë kopien e faqevet të para, në germat origjinale tyrgjishte, duke shtuarë vetë dhe transkriptimin në shkronja shqipe; kjo kopi është bë-rë pas ekzemplarit që ruhetë në teqé të Përmetit.

Po u japim këndonjësvet tánë këtë shëmbllë të vjershëvet fetare të shekëllit të kaluarë, në të cilatë fjalët tyrgjisht, persisht dhe arabishte janë, për fat të keq, më të shumta se nga shqipetë:

* Bull grua myslimane; veç Shkodrësë këtë fjale e gjejmë edhe në Janinë, 'tëpërdorur' edhe kur fjasinë greqisht. Mbase nga shqipeja: e mbulume.

Bismil-lah ej rabbi rahman
 qeremi yt pa nihajet
 ti u bën dertlivet derman
 ti u bën gjuhën që flet.

Errahman ej zati gaffur
 rahmeti yt pa anë
 kë deshe e bëre mesrur
 i hape syte u-lanë.

Ej rahman-i bila zeval
 ej halik-i lem jezel
 ti je alim-i myshqil-i hal
 ti je zat-i bila halel.

Sad hezaran hamd-u thena
 natë e ditë e më çdo vakt
 shesh xhihat-i qylly eshja
 halik-ul-ardi ves' semavat.

Të të bënj shyqyr s' kam kuvvet
 për çdo nefes jad-i hoda
 që na dhe hezaran ni' met
 me iman na bëre ihja

Na bëre lulf e hidajet
 suallëm ikrar-i jeqta.
 na bëre ymmet-i Muhammet
 na nxore na lat-i yza.

Salavat, salam hezaran
 Muhametit resulullah
 hatem-i gjithë pejgamberan
 edhe shafi-i jevm'i xheza.

Që bëre mahbubë habib
 kur e solle nga lameqan
 dyn-jasë u-bëre tabib
 u-bëre dertlivet derman.

Edhe na 't-i bi hesabi
 hazretit Ali Myrteza
 që e pat resulë ehi
 që e lëvdojnë hel eta.

I dërgove zyfekarë
 e the sahib-i la feta
 (këto dy reshta
 mungojnë në kopit.)

Edhe selam pa nihajet
ehl-i bejtit azamet shan
që e lëvdove me ajet
që u dhe bela hezaran.
Me zeher e me xhefa
i bëre esir-i zindan
Shah-i shehitnë në Qerbela
teshne leb e bëre kurban.
Muhammeti me mu'xhizat
dhe me ajet-i furkan
hazret-i shah me zylyfikar
suallnë alemnë në iman.
Mu'xhizat i pejgamberit
edhe velajet-i Ali
e zu faqen e alemit
në një nur në Anadolli.
Haxhi Bektash-i Velinë
kades allahu sirr el aziz
për të bër ymran dinë
me atë zat-i paq dhe temiz,
E ngrite nga Horasani
për të bër ymmetit mëdet
kutb-yl aktab-i zemani
sahib-i sirri velajet.
E fali namazë me hal
e me vet-he i morri
bëri mekam-i bi halel
u-nis për ne Anadolli.
I zuri udhën sulltanit
ryri në sifat pëllumbi
shkoj në taht të la-meqanit
sullxhe kara-Jurt erdhi
Murrë pa shpirt jryydisi
e bëri kadinë gur
mollë taze jaradisi
në tajur bëri zuhur.
Shum' erenlerë kërkoj
me vet-he j'a u bëri bejan
me alametnë e Aliut
ngrehu joll edhe erqan.

Hakën e Muhamet Aliut
e rrëfeu si pati shanë
ay qe varith-i eqmel
nytkun e beri bejan.

Qe sahib-i ilm u amel
edhe rumuz-i tevil-i furkan
me burhan sahib-i q-mal
asëll xhedd-i paq-i Ali
men arefe sirrinë bejan
dhe rumuz-i hajdarit

Rrëfeu hezaran qeramet
bëri irshad njerëzinë
ndezi çirak në alemt
tridhjet e gjashtë mijë.

Bëri irshad dyn-jañë
muarrë vesh ç' është' enbia

Tyrqistan e Anadollë
i nxori nga rah-i zylmet
xgjojti dhe Rumelinë
me atë çirag-i velajet

Pastaj dhe në Gegëri
hodhi saje-i merhamet
dërgoj sulltan Shemiminë
një sahib-i ilm u velajet

U hapi sytë dyn-jašë
Shqipërinë bëri irshad
ndë katar të al-i Abasë
i kalli i bëri irshad

Shumë botë panë hyrë
ndër Shqipëri bëri imran
që u-bënë dedelerë
e gjen' nasib-i zeman.

Bahusus edhe Nasibiu
nga ay pat marrë ikrar
já bëri myjesser Aliu
hodhi mi té bëri nazar

I dha krahët alemit
vate në dergjah-i Alije
ndë lumë të velajetit
vate u-bë perverde.

Si në shumë beni Adem
 që pat lutf edhe ihsan
 edhe me atë bëri qerem
 e u bëri sahib-bejan
 Na e zunë Shqipërinë
 në Danglli bëri bejan
 nga ay qerem-i bi pajan
 na dërgoj Nasibinë
 Tahir dedenë një sulltan
 bëri isbat zotërinë
 Me alem edhe me sanxhak
 e dërgoj si pati shanë
 Erdhi halife me çirag
 ndë Frashër zuri vatanë.

Copa historije

Oso Kuka

Oso Kuka, është i njoftun për trimni e burrni qi pat bâ në Vraninë. Emrin e këti shqiptari e pat naltsue At Gjergj Fishta, me librin „Lahuta e Malcës“ ç' se aj e pat botue disa vjet mâ parë. Gjithashtu edhe dramë origjinal komtâr i „Oso Kukës“ qi mâ se një herë kje luejt në qytetin e Shkodrës, aq mâ fort i a qiti zânin këti burri.

Asht e tepërt qi unë të shkruiej këtu fjalë lavdi e nderimi për Oso Kukën, me qenë se ky pa i a dâ këndohet edhe sot në kangë e në valle prej popullit t' onë; vetëm deshta me njoftue jetëshkrimin e historin tragjike t' tij, si mbas lajmeve qi kam marrë prej fisit të tij edhe prej ca pleqve qi i a kanë arrijtë asajë kohe.

Oso Kuka leu në Shkoder kah vjeti 1810; aj kje i biri i Abdullah Kukës, i cili pat qenë bajraktari i Mustafa Pashës, vezirit të Shkodrës. Oso-ja me shtat kje mesatâr, burrë i pashëm, me musteqe të zeza; sÿt i xixillojishin pors i dy gaca; krÿt i a mbulonte një perçë e madhe edhe e zezë si penda e korbit. Oso Kuka u vishte shkodranisht, me gubere të kuqe e të qindisun mbrapa me âr. Aj në sylah të brezit vëte kubure dhe tagan.

Oso-ja, ç' n' e rí të vet dukej se do të dilte burrë trim e i rreptë për pushkë. Koha e bâni t' ikë prej Shkodre, dhe të marrë udhën e

Anadollit e të ca vëndeve të tjerë të Turqís; njizet e shtat vjeç ndëj larg prej qytetit të vet. Kët kohë aj e kaloj nepër gjytetet të Tarabullusit, të Halepit, të Rumelís, të Dibrës e të tjerave; në këtë rasë, aj mësoj mirë me folë turqishten. Kur u këthye në Shkodër Oso Kuka, që emnuem kapitan i asajë çete ushtarake për roje të kufinit nga âna e Mëlit Zí, në Vraninë. Osoja me këtë gradë shërbej njimdhet vjet.

Duhet dijtë se Vranina âsht një ishull në breg të Liqenit të Shkodrës; aso kohe pranë kufinit të Malit të Zí, kundrejt ishullit të Lesendres. Në Vraninë përveç disa ksollave shkjeshtë nuk banojshin shqiptarë; aty ndodhej një kullë, e kund pës minuta mâ tutje gjindej edhe një tjetër e quejtun Maksud Kullë, n' êmën t' ati oficeri q' e kishite ndertue. Një kullë tjetër prap gjindej në Lesender; një e katërt ishte në mjedis të Vraninës dhe të Lesendres. Kjo e fundit emnohej kulla e Monastirit. Kulla e Vraninës, mâ parë kishte qenë shpija e një vrançarri, i quejtun Kosta Martini, i cilli për mos me lanë qi shpija t' i bahej kullë, i dha zjarmin. Mandej mbi ato troje kje themelue kulla e Vraninës.

Ngatresat e të huejve. — Ç' me kohna të vjetra e sidomos me marimin e sundimit të vezirave të Shkodërs, malazest shpesh herë qitnë trazime të mëdhenj në kufinin e Shqipnís, edhe shumë herë shhaktuen luftime të përgjakshmë me shqiptarë. Malazest të shtymun prej Rusís, me qëllim qi të fitojnë ndo' i copë toke të Shqipnís — sikur thotë: vjershtari në Lahutën e Malcís :

Veç me turk si të nisi fjalë,
 Per me mujtë m' i a marrë Vraninen
 Për me mujtë m' i a shty krahinen....
 Pse Moskovi e ká pleqne
 Shqiptarin ne me n' a lshue.

Në vjetin 1862 nisin të qesin trazime nga ana e Malcís së Shkodrës. Kund një muej përpara se të rrethohej Vranina, Malcorët e Hotit dhe të Grudës luftuen me Malazest edhe prenë mâ se tridhet krena. Këto koka të preme i sjellin në Shkodër ke Abdi Pasha, valiut të Shkodrës; por ky i porositë malcorët qi mos të bijnë mâ edhe një herë krena të prêm në qytet

Nuk kalon një muej e vrançarët po duen me i rá kullës së Vraninës. Oso Kuka gjindej në Vraninë që në vjetin 1859 si kapiten (jusbash) por gjithnji i vishun shkodranisht.

Oso-ja heton trathitín e Vrançarëvet, edhe një ditë xën gjashtdhjet vetë prej tyne; d. m. th. nga një për shpí.

Këta gjind i mban të burgosun; me gjith këtë në krý u vëndon.

qeleshe të bardha me qenë se ata barshin në kry kapica¹) për me diftue vedin se janë shkjë! Kùr Oso Kuka po gatohej me i nisë vrançarët për Shkodër, qe se i a arriji Abdi Pasha më një avullore kinse me inspektue kullai e kufinit. Oso-ja ishte ulë në Lesendër bashkë me ata të burgosunit; këtu takon në Pashën, e në sa bisedime qi bâni me të, i ankton se kullën e kishte të çartun e se kishte nevojë për me e meremetue. Abdi Pasha kur don m' u këthye merr vrançarët me vedi, edhe Oso-s i premtën se do të i a ndreqte sá mâ parë.

Të rrethuemt e kullës.

Abdi Pasha mbas pak ditsh i liron vrançarët prej burgut qi të vejnë në shpijat e tyne.

Nuk vonon shum e grindja nisë përsrí, në kët mëndyrë:

Vendasit e Lesendrës me ata të Ljubotinës merrshin e jepshin gra në mjes tyne. Bijat e përzieme si shkojshin e vijshin nëpër gjinit e tyne kishin zakon me marrë nga një perpeq me vedi kùr këtheheshin.

Në një këso rase disa ushtarë t' Oso Kukës ndodhen në vâ të Vraninës, e grave qi kalojnë aty pari u marrin perpeqat me pa hír! Këto u thonë burrave për ç' ka u kishte ngjajt. Burrat i bajnë me dijë Oso Kukës për at ngjarje, e cila ishte një kore për tá.

Oso-ja nuk i dha randsi një herë asajë pune; por kùr pà se çashtja gjithnji po shkon tue u pezmatue, dhe idhnimi i ljobotinasve vinte tue u shtue, atëherë mendoj të qesin roje kah vau qi kështu mos të mesin i rethuem befas prej malazezve.

Këtë e përmendë dhe vjershtari në Lahuten e Malcís:

„Merr Vuksân — edhe Sinan

Merr qat Kerrnin Zagorjanë

Edhe dilni sogje n' vâ,

Pse mjesnatë tash â tu rà.

A thonë Shkjau, qi besë nuk kâ*.

Vërtetë, shkjet bashkohen dhe nisen të dalin ván për me rrethue mandej kullën e Vraninës. Në kët kohë, kùr malazezt nisen me mësy kullën, kërset pushka, por Oso Kuka nuk kishte fuqí aq sa me u bâ ballë gjith atyne; atëherë Oso-ja me njerzit qi kishte zmraptet dhe hynë në kullë. Malazezst rrethojnë kullën dhe shtërgojnë Oso Kukën me shokë qi të dorzohen; por Oso-s, duket se j' a kish ndí zëmra ç' se u pa me Abdi Pashën kurse ishte në Shkodër. Pasha Oso Kukës i thirrite (Gjaur Osman) me qenë se ky ishte mësue me bâ qejfë, e në liri. Abdi Pasha e thret Oso-n edhe i thotë se: „Ti nuk je tue mbajt roj-

¹ Kapica është një kuslë apostafat e malazezve.

tarë aq sa të kam thanë! „Oso Kuka atëherë i u përgjegj tue i thënë — Pashë, Pashë! Në qoftë se malazezt guxojnë me më trazue mue, ke me pá se ç' ka kam për t' u bâ; e t'a dishë se i gjallë nuk dorëzohem kurr, por ke me ndie edhe ti se kush asht Oso Kuka!“

Pra, Osoja i rrethuem mblodhi gjith shokët e vet për me kuvendue se qyshë do t' i a bajshin. Sa për vedi, Oso Kuka e kishte qitë ceken mos m' u dhânë i gjall në dorë t' anmikut; pse aj më një nuk donte të korisin komin e vet qi s' ishte mësue t' i perulej shkjaundo' i herë, e n' anë tjetër aj s' dishronte me i a lirue tokën anmikut, të cillën e kishte marrë barrë me e ruejtë. Pra, Oso-ja e dan mendimin për me qindrue deri në mâ të mramen pikë të gjakut; sikur shkruen Lahuta e Malcis:

Ëhu. Mallkue kjoftë njaj n' Shqipni:
Kjoft mallkue a plak a i rí
Qi për mbret e për lirí
S' çohet sod me armë mizore
S' lidhet sod me besë arbnore
Për me dhânë mâ para jetën
Për me shkri mâ para vleftën
Se me rá fisi i Sdqyptarit
N' thoj të pa ngishmit Gospodarit.

Oso Kuka për mos me marrë në qafë shokët e vet, u thotë „Kush të duen mundet me dalë ose le të bajnë deken e burrave këtu në Kullë!“

Të gjithë u betuen me qindrue deri në të mbramen. Oso-ja kishte me vedi edhe Sal Behrin, të nipin e vet, një djalë të rí pesmdhet vjetsh, por shumë trim. Kur Oso-ja desht t' a nisë këtë për Shkodër Sala nuk ndigjoj kurrsesi, e mâ në fund i thotë Oso-s:

— Shih Dajë! Ç' ndryshim ká dora e ême me dorën t' ande? Edhe un pra dishroj me ndejë këtu me jú, e sado qi jam i rí due të vdes për dhën e të parve të mí, për nderën e besën të komit t' êm. Tek e mbramja së kam ç' u baj as prindvet, pse ata vetë më kanë rritë për kët ditë!

Burrat e rrethuem në kullë, u dán se i cilli nëpër franjija për me qindrue; filloi lufta rrebsisht, e Malazezt gjithnji vinë tue shterngue kullën. Në mes të luftimit qi po vazhdonte Oso Kuka plagohet, por plaga nuk e lodhë aspak, veçse i jep zëmër mâ tepër me qindrue. Me Oso Kukën bashkë ishin njizet e katër vetë të ndrým në kullë¹. Këty-

¹) Emnat e tyne ishin: Sal Behri, Met Golemi, Met Begja, Ibrahim Kopliku, Pjeter Berisha, Isuf Bushati, Met Vela, Sadik Lapi, Zylfo . . . , Nuzi . . . , Mahmud Zyberi; tjerëve nuk i' u dihen emnat; 3 a 4 prej këtyne të fundit ishin toskë; Pjetri ishte shërbtori i Oso Kukës.

ne mbas njij kohë luftimi, u marohet municjoni; ndihmë prej Shkodre nuk kishin akoma, atëherë Oso-ja mendon edhe vendon qi me i dhënë zjarmin barotit, qi kishte në kullë pranë vedit. Por përpara se do të bënte këtë vepër të mnershme, u-mundue të mbledhí sá ma shumë Malazez përmbí e për rreth kullës, qi kështu t' a paguete vedin mirë. Shkjetë, tue besue se po dorzohet Oso Kuka, u-mblodhën shumë, disa edhe në pullas hypën.

Për këtë radhë Poeti i Lahutës s' Malcís thotë:

Me brohorí tu lutë jetë Knjazit,
Nji qind vetë kcyen n' kulm t' pullazit,
Mâ të përmendëmit kah trimnija;
Njaq u njitne mbí frangíja.

Në Qershuer të vjetit 1862 Oso Kuka vendimin e dhanun e kryen, edhe prej agimit i jep ziarm barotit tue shkruí jetën e vet bashkë me të shokve dhe të gjith Malazezve qi kjenë përbrí Kullës. Kët ças Lahuta e Malcís e përshkruen shumë bukur me fjalët e Oso Kukës:

„Ah! Kada!ë Nikollë të vraftë Zoti!
Pse këtu i thonë Oso Baroti;
Se s' ke pa Shqiptarë me sý,
Se djeg vehten edhe tý!“

Si mbas kangës popullore thohet që janë vra mâ se dyqind vetë prej Malazezve. Kur u-muer vesht të rrethuemt e Oso Kukës në Vraninë, shumë shkodranë nisen me i shkue në ndihmë, por kúr sosën në Maksud-Kullë, Kulla e Vraninës po digjej e gjith luftarët ishin bázharri; vetëm Sal Behrit, të nipit Oso Kukës, i kishte shpëtue nji pjesë e krahut pa u djegë. Këtë e njofti i vllaj, Nag Behri, i cilli jeton akoma sot, edhe ky shkoj në ndihmë bashkë me tjerët. Burri plak qi sot jeton me disprim meriton m' u quejt Veteran Shqiptár. Ky thotë se „Vllanë e njofta në nji pjesë të krahut qi nuk i' u kish djegë, me qenë se aty ka pasë nji tatim (mëhyrë të shtim me gjylpanë)“. Me kaq maron kio tragjedí historike, therorí e famshme e Shqiptar, e të cillën po e mbyllim me këtë vjershë të At. Gjergj Fishtës, e mandej me kangën popullore.

O ata të lumët qi dhanë jetën
O ata të lumët q' shkrijnë ve'ten,
Qi për Mbret e vënd të parve,
Qi për erz e nder të Shqiptarve
Derdhen gjakun tuj luftue
Porsi të parët u pa'n punue!

Kanga popullore

e

Oso Kukës

Të Mërkurën, në dy sahati,
 Ishte mbledhun Mali i Zî;
 Osmanagës na i vojti xhevapi
 Vranina t' është bâ hasî.
 Osmanaga tha nji fjalë:
 Mos ja hiqni gozhdën derës,
 A s' i njifni Vraniçarët
 Se janë qena të pa bés?
 Ç' ka po thot e zeza Shkodër?
 Na ndihmë paçim Perëndinë,
 Me lot kjajnë i math e i vogël,
 U doq Osja në Vraninë!
 Ti Nikollë i biri i shktnës,
 Shpejt i mbloodhe tetmî vêt....
 Me i bâ yryç Vraninës
 Kû janë lidhë burrat me vdekël!
 Po ndigjo, bre Nikoll popi,
 A së ke pa Shkodranë me sÿ?
 Mu më thonë Oso Baroti
 Qi djeg vedin edhe tÿ.
 Po shkina me këto lajme,
 Ç' ka na bâni Oso Kuka:
 Perenikt i dogji fare,
 E Dodosht' i shtîni në futa.
 Me këto lajme vojti shkina,
 Po ndigjo more Nikollë,
 Për pa u-djegë gjith Vranina
 Osmanaga nuk bjen në dorë.
 Osmanaga del në pexhere,
 Yryç ban tuj u hallakatë,
 Jena bamun muhasere,
 S' ka kah vjen Shkodra imdatë!
 Salja i vogël nji grimë fëmî
 Shokve vet u nep garjet,
 Jalla burra në franjî
 Se shkojmë lule për xhenet.

Salja i vogël, Met Golemi
 Bajitin luftë si dy asllana,
 Na së mund të rrimë me na djegë zjermit
 Por do të pritenë me kapidana.

Sal Behri një grimë fëmijë
 Hyp nët e i thret Ezanit
 Bini burra për Shqipëri,
 Sot për ne është ditë Bajramit.

Sal Behri e Met Golemi
 Në krallhane janë rrethue
 Se t'a dinë të gjithë alemit,
 Osmanaga na u varrue.

Hajde, hajde Osmanaga.
 Për dyn-ja së paske mëndue
 Në katër qoshet j' u-dha flaka:
 Nami yt së ka me u harue.

Na kurrë vojtme, në Maksud-Kulltë
 Krisi topi e kombaraia,
 Osmanaga digjej nur,
 Rahmet i jep gjithë dyn-jaja.

Krajl Nikolla thot një fjalë,
 Me uryç në kullë me hÿ
 Oso Kukën e due gjallë
 Se është nëm për Mal të Zi.

Ç' ka po i gjegjë Nikollës Shkjenimi?
 Në Vraninë me çue imdatë:
 Asht rrethuemun Oso trimi
 E s' bjen në dorë pa u ndezun flakë.

M' katër anët rrahë telegrafa,
 I vojt lajmi të gjithë krajlis,
 Ah! të lumtë, bre Osmanaga,
 Ç' ja kë zbardhë faqen Shqipëris!

Ditë e natë tuj kjamun shkinat,
 Kuku bajnë se ç' na ka gjetë;
 Habiten si ndezen trimat,
 Kush i gjallë nuk paska mbetë!

Osmanaga burrë bejleku
 Me njëzet e katër vë,

Krent' e vramë edhe të vdekun
Mâ shum janë se dyqind vèt.

Nikol popi, ka kalxue
Me kët punë së fitova gjâ,
Ç' ka m' a bani Osja mue
S' ma ka bâ kërkush në dyn-ja!

Osmanaga me nji herë
Me gjith shokë lidhi kët bës:
A mâ mirë me vdekë me nderë
A me rrunue me faqe të zezë?.....

Luftime tjerë ndërmjet të shqiptarve e të malazezve.

1) Lufta e Kernicës:

Si mbas këngve e gojdhânave popullore, luftimet ndërmjet të shqiptarve e të malazezve kanë fillue ç' me kohë të motçme, e sidomos ato të shekullit XIX janë shum të përgjakshme. Keta luftime përgjithësisht udodhen nga ana e Shkodrës, prandej shum shqiptar nuk mund të kenë kurrfarë dijenije mbi ngjarjet e atyne kohve: pse shënimet me shkrim kush nuk ka mbajtë qi me i botue edhe mos me i lanë të humbasin! Me qenë se këta luftime, tue i marrë veças, sajojnë nga nji copë histori, unë u mundova me i mbledhë disa prej tyne nepër popull qi si gojdhana fliten gjithnji, e mâ tepër n' at rasë kûr donë me tregue burrnin, trimnin e besën shqiptare. Qëllimi i të shkruemit të këtyne copave historije, nuk është vetëm me tregue luftat qi Shqiptarët kanë bâ me Malazez, por mâ tepër është me mujt e me njallë, a mâ mirë të themi, me rrânjosë në zëmrat e brezit të ri njatë besë, burrnin e trimnin qi patën dikur të parët t'onë.

Luftimet ndërmjet të shqiptarëve me malazez janë shum; e nji varg i tyne fillon me luftën e Vraninës qi u dftue mâ parë, mandej vjen kjo e Kernicës.

Kernica është nji vend i vogël në krahin e rrmajtë të Liqenit të Shkodrës. Kernica ishte nji nga mburojet e shqiptarëve kundër Malit të Zi. Lufta e Kernicës është e njoftun, në mjes të vendasve të krahinës së Shkodrës, nji ndër luftat mâ të përgjakshme. Nji vjetë mbas të djegmes së Vraninës, Malazezt përsri shtin trazime me qëllim qi të fitojnë edhe ndó i vend tjetër. (Në mot 1863).

Kah vjeti 1853 malazezt rrethojnë Kernicën; lajmi i këtij rrethimi vjen në Shkodër, e populli i qytetit dishprohet tepër kundra malazezve; përnjherë rrokë armët në dorë edhe vendon të shkojë atje. Këti vendimi i përgjigjen pik s' parit pesqind vetë shkodranë, ulqinakë, e pak malcorë, tue pasë në krye Hasnag (Hasan aga) Hotin, burrë të njoftun për trimnín e derë të parë; ky kishte një influencë të madhe mbi malcín e Shkodrës. Këta pesqind vetë luftarë mblidhen në vá të Kernicës; këtu presin edhe ndihma të tjera prej rrethevet të Shkodrës. Por kaloj një kohë e gjatë e kush nuk erdhi; atëherë luftarët shkodranë nuk presin mâ e donë të shfrehnë sa mâ parë menín kundra anmikut të pamshirshëm, edhe nisen për në lamë të luftës.

Që kur se hyjnë në luginat e Kernicës, fati këtu nuk u ecë, taktika e luftës nuk u ndihmon, edhe mbesin të rrethuem prej malazezve. Këta male të shkretnuemë lahen me gjak të shqiptarvet, me gjakun e deshmorëve qi ishin lidhë me besë për mos me i rà në dorë anmikut. Krisi pushka, e anmiku nisë të mësyme të rrehta kundra shqiptarvet; këta e presin burrënisht edhe e damtojnë tepër anmikun. Dikúr shqiptarvet u mbarohet municjoni, por këta nuk lodhen: atëherë fillojnë me përdorue taganat e me mija malazez mbesin të vdekun në lanë të luftës. Në kët luftë të tmershme shkrinë jetën edhe pesqind vetë shqiptar, prej të cillve vetëm dy vetë shpëtuan: Halil Kopliku e Çun Mula, bajraktar i Hotit. Ndo kuj ndoshta ky numur ká për të ju dukë i madh, por rrethanat popullore janë një fakt i gjallë i këtyne ngjarjeve. Sidomos kjo luftë e përgjakshme sod përmendet si proverb në Shkodër, në rasë të ndo i kerdí të madhe qi ndodh. Këta lloj luftimesh e trimnish shqiptarin e kanë bâ të njoftun në botë edhe, deri vonë u mbajte si shembëll trimnije komi i jonë.

Hasnag Hoti për të cillin thám se ishte i pari mbi luftarët shqiptarë të Kernicës, me qenë se mbetet vetëm e i pa fuqí, xêhet rob prej Malazezve. Kjo luftë merr fund me fitimin e Shkëve, por me gjith këtë áshht për t' u vù oré besa qi Shqiptarët lidhin ndërmjet vedit për mos me i u poshtnue Malazezve, e mandej me i lanë një njollë të zezë historís komtare.

Kanga e Kernicës

Ibt da sen-ja me tetë *

Turqënija u çue në kambë

Kush të doen me imàn me deké

Në Karadak t' a bajnë bejanë

* 1278 pas motit rumi.

Rrahi teli për Stambollë
Janë rrethue disa asllana
Hasan Hoti me Shkodranë
Muhasere në Kernicë

Mbas gjith halleve të Kernicës
Halilin e xunë gjallë
Veç raja e Podgoricës
i a rrethoj Kuçit Kalanë

Moj kalaja e Medunit
Tridhet dit ke ndej rrethue
Të kisha pasë shkallat prej guri
S' kish muejt kaurri me t'u afrue.

2) Lufta e Shestanit dhe e Muriqit.

Nuk kaluen shum e mbas disa muejsh Malazezt, të hasdisun prej fitimit qi kishin bâ në Kernicë disa kohë mâ parë, mundohen të këpusin gjithnji ndo i copë tokë shqiptare. Kështu mësyenë Muriqin e Shestanin, dy vënde të vogjël të banuemë përgjithësisht, n' atë kohë, prej shqiptarve. Këto dy krahina gjinden nga ana e Ulqinit.

Në kullën e Muriqit gjindej një farë burri i quejtun..... Sollaku, po prej ati katundi. Ky trim shqiptar po falte sabahun, kûr qe lajmohet se është i rrethuem prej Malazezve, edhe këta lypin dorzimin e tij me gjith shokët e tjerë. Këta burra, mbassi kryejnë nemazin, bahen me qindrue e të mos i bien në dorë Shkaut. Para se nisin luftën rreshtohen si mbas planit q' u dha i par' i tyne Sollaku. Ky heton mâ parë se, cilli nder Malazezt meriton plumbin e parë, dhe atë giuen në pushkë e e len të vdekun. Me këtë rasë fillon lufta rrebsisht, e në vazhdim e sipër i jepet zjarmi kullës por e ndal'n me anën e ufullës të një fuçije. Lufta vijon gjithnji, e një mâ i forti prej Malazezve kapërcen ledhet për me hý n' oborr të shpís, por mbetë i vdekun. Grueja e shpís hapë derën e kullës edhe me një këmesë në dorë del e i pret kryet.

Lajmi i këtyne luftimeve arriti në Shkodër; përs'ri populli i këtt qyteti çohet në këmbë për me i dalë zot vendit e vllazënve të tij.

Ndihma e Shkodërs smrap Malazet, të cilët mandej luftojnë në Shpuzë. Sa për Shestan, këtu nuk bâhet luftë.

Hamdi Bushati

Kënka e sprasme e Ballës,

Vjershë e pa leçiturë e Gavrilit i Dharënjëvet. Katanzare. Në stipëshkronjë të Sepës të Kalioit, 1906.

Ky është titulli i një libri prej 277 faqesh në prozë e në vjershë. Prej faqes 22 deri 75 inkluziv, ka një parathënëje në prozë, ku flitet mbi Ballën, mbi vjershat e librit e mbi shpërnguljen e Shqiptarëve në Itali. Prej faqes 82 deri në fund dahet në katër pjesë, e para ka 4, e dyta 1, e treta 2 dhe e katërta 2 vjersha me tituj të ndryshëm e në vargje shtatë e tetë rrokjesh. Si parathënëja në prozë është edhe vjershat kanë përkundrejt përkthimin në italishtet.

Pas parathënëjes autori i këtyne vjershave t' emnueme është ka pasë qenë Balla, familja e të cilit bashkë me të tjera nga parësija e Shqipnis vajtën, pas vdekjes së Skënderbeut, në Itali e themeluen katinin Palazzo-Adriano të sotshëmin, në Palermo të Sicelis. Thonë se familja Balla rrjeth nga Balshajt, një nga familjet princore që ka pasë sundue gjith Shqipnín bashkë me Malin e Zi, thuejse një qind vjet përpara Kastriotëve. Vjershat e Ballës, që ai duket se i ka sjellë me vehte nga Shqipnija, i qiti në dritë Gabriello Dara që ishte një nga familja Dara e shpërngulun edhe kjo prej Shqipnije në Itali, mbë 1482. Gabriello Dara (1826-1885), njeri letrar, vjershëtar, filosof, arkeolog dhe jurist, punëtuer i gjuhës shqipe e plot me mall e zjarr për vendin e stërgjyshëvet të tij, i muer këto nga i ati, Andrea Dara, që i kishte mbledhë andej-këtej nga goja e popullit, edhe i emnoi me titullin „*Kënka e sprasme e Ballës*“. Përveç këtyne vjershave Andrea Dara paska lanë, pas parathënëjes së librit, edhe të tjera vjersha e shkrime mbi Shqipen, të pabotueme edhe.

Vjershat e këtij libri u-botuen së parit në të Përkohshëmen „La Nazione Albanese“, e mbasandaj më 1906 si libër, por vetëm në 80 ksombëla.

I gjithë libri është shkruar toskënisht, me forma më tepër të Labërishtes, e është fort interesant për vjetërin e këtyne formave e për disa fjalë të vjetëra që nuk përdoren sot në gjuhët t'onë e që duhen vëzhgue mirë etymologjisht e syntaksisht, që të mund të hyjnë në përdorim të sotshëm të gjuhës. Veç kësaj, libri ka edhe shumë fjalë greqishte. Pas fjalëve të të ndjyerit Giuseppe Sciró-it, i cili, si më thoshte, kishte një dorëshkrim tjetër të kësaj vepre, libri ka dalë me gabime shtypi, ndoshta edhe asosh që quhen *lapsus calami* e *linguae*, e prandaj do t' ishte mirë të bëhej një rrim e një studim tjetër i fellë i kësaj vepre.

Mâ parë po shkruajmë këtu një copë nga parathënësja e librit tue ruejtë besnikin e tekstit, tue e përkthye në formët të sotshme të gjuhës e tue i bâmë sqartimet e duhuna, por tue e përskruie n' alfabet të sotshëm të gjuhës:

Prindët t' ân, çë kur, ikur Arbrit, erdhën e stisën Katundin i Palac-Adrianit, ndë vitin 1482, ruatin po çelur ndë zëmmërën kujtimën e mallin Atëris sbiërr.

Prindërit t'anë që kur iknë nga Shqipëria dhe erdhnë e themeluan katundin e Palac- Adrianit, në vitin 1482, ruajnë gjithënjë të ndezur në zemrën e tyre kujtimin dhe dashurinë e mëmédheut të humbur.

Prindët. Shumësi i fjalës *print-di*, ruhet këtu rregullisht si në Gëgënishte të sotshme

Ikur arbrit. si iknë nga Arbri. Asht fjalë kohore e *pashtjellme* (*implicita*) që përdoret nga ndonji herë edhe në gjuhë të sotshme Për të verejtë është këtu trajta e thjeshtë e ablativit, *Arbrit*, në vend të *nga Arbri*. Ablativi i thjeshtë, d. m. th. pa ndonjy prepozitë përpara, përdoret shumë shpeshë në këtë libër, si në prozë ashtu edhe në poezi, kurse në gjuhët të sotshme ablativi nuk përdoret i thjeshtë, por i bashkuar me prepozitën *nga a prej*. Me gjith' atë, edhe gjuha e sotshme e ka ruejtë në disa të foluna formën e thjeshtë të ablativit. Themë p. sh. luej *vendit*, plasa *vapës*, des *unit*, qasu *dritës*, shqyhem *gazit*, ra *nderit*, më duel *dorës*, e hoqa *qafës*, etj. etj. Nga këto shembëlla, e nga të tjera si këto që kam mbledhë, duket se gjuha e jonë e ka pasë rëndom trajtën e xveshun të ablativit sikurse edhe latinishtja; tue hymë në jetën e saj analytike erdhi tue u-rrallue përdorimi i ablativit të thjeshtë, por nuk u-shduk krejt, sikundrë që ngjan kjo punë në gjuhët neolatine e të tjerat gjuhë të reja; e është mirë që të ruhet kjo karakteristikë e vjetëris së gjuhës s'onë tue u-përdorë frazët e sipërme e të tjera që gjënden në gojë të popullit, si p. sh. lahem *faqesh*, krifem *flokësh*, me zi e qita *duersh*, nuk qitet *krenësh*, etj. Sa për fjalën *Arbrit*, duhet ditë se Italo-Shqiptarët nuk e njofin fjalën Shqipni, por dijnë *Arbrin*. *Arbër-i* është për ata Shqipnija, e *Arbresh-i* është Shqiptari.

Erdhën e stisën. Folja *stisën* është greqisht, sikurse fort lehtë e kuptojnë ata që dijnë këtë gjuhë. Për t' u-vumë re është këtu se veta e tretë e shumësit të aoristit nuk mbaron më *në*, sikurse mâ të shumtën thohet sot toskënisht, si *erdhnë, iknë*, etj., por mén më *ën*, si edhe gëgënisht.

Katundin i Palac-Adrianit. Ajo që bie në sy këtu është nyja e përparme *i* që përciell gjenitivin pas një akuzativí, tek që në gjuhën e sotshme kemi gjithënjë nyjen *e* pas akuzativit. Kjo është një rregullë

karakteristike e gjuhës së Italo-Shqiptarëvet e një çashtëje që do rrnuje e vëzhgue hollë.

Ruatin po çelur. Edhe kjo formë e aoristit ndëgjohej në Toskënishtet të sotshme, në vend të asaj më të zakonshemes në gjuhët të shkrimit, si *ruajtnë, vuajtnë, quajtnë*, etj. Fjala *po* ka kuptimin e *gjithmonë-s* në këtë dialekt, kurse fjala *por* përdoret me domethënëjen e sotshme. Folja *të çelur* ka kuptimin të *ndezur* të Italo-Shqiptarët; por edhe ndër ne e ka këtë kuptim, pse thohet sot: *çel zjarrin* = ndez zjarrin.

Ndë zëmmërën. Kurdoherë fjalën *zemër* teksti në fjalë e përdor me dy m; krhs. *zëmbër* sot.

Kujtimën. Edhe në gjuhët të sotshme kemi këso fjalësh, me prapashtimin *im* që janë femna e meshku; p. sh. *ushtim-i* e *oshëtimë-a*, etj.

Atëris sbiërr. Ndo neologjizëm qoftë fjala *atëri-ja* (e bame pas greqishtes *patris* e latinishtes *patria*) ndo e folun qoftë në gojë t'atij populli, më duket më e mirë se fjalët *atdheu* e *mëmëdheu* (për këtë të fundit flet N. Jackl-i në f. 83 të librit „Naim Frasheri“), e nuk do të që keq, sikur të futej në përdorim të sotshëm të gjuhës.

Sbiërr. Folja me *bjerrë*, që përdoret sot vetëm në Gegënishtet, e medjë n'atë të sipërmen, në dialekt të Italo-Shqiptarëvet përdoret në formën e sipërme, tue marrë një s epenthematik. Por edhe në gjuhët të sotshme kemi këso foljesh, ku shkronja s nuk lot ndonji rrol; p. sh. *madhoj* e *smadhoj*, *vogëloj* e *svogëloj*, etj. Për orthografin e këtyne foljeve Kristoforidhi në Gramatikët të tij shkruen se duhen shkruje me s e jo z, *zvogëloj*, etj.

Një tjetër gjâ për t'u-verejtë në këtë dialekt është edhe puna e zanorevet të gjata që janë rrujtë, si në Gegënishtet. I pamë p. sh.: *prindët t'ân* e jo *t'anë*; *atëris* e jo *atërisë*, sikur kishin me u-shkrue sot Toskënisht; e këtë prosodí do ta shofim edhe ndër fjalë të tjera të këtij dialekti.

Ati birit e biri nipit rëfiejn punët të shkëlqieme e luftat të nderme, cilat u luftuan ndë môn i Skanderbegut; se ahiera vetëm përsë-pari e alëmenô përsë-sprasëmi, gjith Bulëria, gjith trimëria e Arbrit, burra e graa, pleq e të ri patën një zëmmër, tue dashur nderjen e lefterin e dheut ç'i leu, e çë do njëri desh e deshën të gjith.

I ati të birit e i biri të nipit rëfenin punët e shkëlqyera e luftat e ndershme, që u-luftuan në kohë të Skënderbeut; se atëhere vetëm për herë të parë e mjerisht për herë të fundit gjithë parësija, gjithë djalë-

rija e Shqipërisë, burra e gra, pleq e të ri patnë një zëmër, duke dashur nderjen e lirin' e dheut që i lindi, e atë që desh njëri e deshnë të tërë.

Punët të shkëlqieme e luftat të nderëme. — Æsht për t' u-verejtë këtu nyja të që përciell rasën kallzore në shumës, kurse sot thomi më zakonisht punët e shkëlqyera, luftat e ndershëme. Porse edhe sot përdoret nyja të në këtë rasë, e më fort në dialekt të Korçës. Mbiemnat e prejardhun nga emnat Arbëresht i formojnë gjithënjë me prapashtimin *m*, p. sh. i nderëm, i përlipëm, i fanëm, etj. De Rada ka mbiemnin *i përborëm*, e nuk është keq të imitohet edhe sot kjo mënyrë formimi.

..... *për-së-pari e alëmenò për-së-sprasëmi*. —

Janë forma të rregullshëme lokucionesh adverbialë, sikurse ato të sotshmet: *për së largu*, *për së afërmi*, etj. Mbiemni *i sprasëm-i* (fort elegant e për t' u-imitue) përdoret tek ata në vend të sotshëmvet *i prapëm-i*, *i mrâmë-i*, *i mrapëm-i*, *i funtmë-i*. Fjala *alëmenò* është interjeksion greqisht e do të thotë *mjerisht*.

... *Bulëria trimëria*. Sot na ka mbetë vetëm fjala *bujar*, ata përdorin edhe emnin abstrakt *bulëria*, për parí a parësi. Fjalët *trim*, *trimëri* tek ata kanë kuptimin e fjalëvevet *djalë* dhe *djalëri*.

Graa. Për t' u vumë re është këtu zgjatimi i zanores *a* që shkruhet dyfish, kurse në fjalën *aterís* që pamë e në tjera fjalë kështu zanorët e gjata shkruhen me theksë përsipër.

... *lëfterin e dheut ç' i leu*. Fjala *lefteri* është greqisht. Lokucionin elegant *dheu ç' i leu* është një synonym i fjalës *atëri*.

Çë ahiera embri i Arbrit u-harrua ndëmôn, e ajo hor e ai gjak, cilët kishin thamasur jetën bëmashit urteris, qëntruan nd' errët njera më nani; e daft Perëndia se të shuhet nëma e moçëme që gërisën gjinden t' ân, lër sa të zotròft në shtrëngohëshin prap ndë përzitën të pâr, Krështenj e Maometan, Katolik, e Orthodhoks që të klofshin, tue lojasur se jan vet' t' Arbresh.

Që atëhere emëri i Shqipërisë u-harrua me kohë, e ay vënt e ay gjak, të cilët kishin çuditur botën me puntë e trimërisë, qëndruan n' errësirë gjer tani; e dhëntë Perëndia që të shuhet nëma e qëmoçme që përçan kombin t' anë, të lindur që të zotëronjë, në u-shtrëngofshin prapë në bashkimin e parë, të Krishterë e Muhamedanë, Katolikë e Orthodhoksë, sido qofshin, duke mejtuar se janë veç Shqipëtarë.

Ajo hor; fjala *hor* është greqisht e d. m. th. vend.

Kishin thamasur jetën bëmashit urtëris. — Folja *thamasur* është greqisht e do të thotë çuditur. Në Shqipni të mesme e sidomos n' El-

basan përdoret (por prej të Krishtenëvet) verbi me *u-thagmitë* me u-çuditë, e emni *tagëm-a* mrekuilli, çudi. Ndaj Arbëresht fjala *jetë-a* ka kuptimin e *botës*; *jetës* ata i thonë *gjell-a*. Interesant asht këtu fjala *bëmashit*, që është një ablativ shumuer i fjalës *bëmë-a* = të bërë, e bame, e këtu ka kuptim e *res gestae*. Fjalët *i urtë*, *urtëri-ja* ndër Arbëresht kanë kuptimin e *trimit*, *trimërisë*, por edhe të *të diturit* dhe *të diturisë*.

Qëntruan nd'errët. Në këtë dialekt ruhet gjithënjë *t-ja* pas *n-së* e nuk kthehet në *d*, si ndër ne. *Nd'errët* = *në t'errët*.

E daft Perëndia = dashtë Perëndia. Kjo formë e optativit e verbit me *dashë* përdoret edhe sot në Çamërishtet.

Çë gërisën gjinden t'ân. Përemni lidhuer të Arbëresht ka gjithënjë këtë formë e jo *që*. *Gërisën* është vetë e tretë e tanishmit e foljes *me gërise*; unë *gërisënj*, ti *gërisën*, ai *gërisën*, sikurse edhe: *ikënj*, *iken*, *ikën*, *ecënj*, *ecën*, *ecën*; etj. Folja *me gërisë* përdoret edhe ndër ne sot me një shqisë pakë të ndryshme.

Lër sa të zotroft = lindur që të zotëronjë. Karakteristike në këte dialekt se fjalit qëllimore (praepozitio finalis) ndërtohen gjithënjë me lidhëzat *që të* ose *për me a për të*. Shqiptarët e Greqis këto fjalë i ndërtojnë kështu: *për të shoh* = që të shoh; *për të vete* = që vete, etj., e fort më duket që këtë mënyrë e kam ndëgjue edhe prej ndonjenit nga Labërija.

Ndë përzitën. Fjala *përzitë a* tek ata ka domethënëjen e bashkimit.

Çë të klofsh'in = që të jenë, sido qofshin. Sikurse në fjalën e sipërme qëllimore, *sa të zotroft*, kështu dhe në këtë lidhoren, *çë të klofsh'in*, për të verejtë është mënyra (modus) optative e verbit e jo ajo subjunktive, sikurse sot: *që të zotërojë*, *që të jenë*.

Tue lojasur = tue mendue. Folja *lojas* është greqisht.

A. Xhuvani

BIBLIOGRAFI

Statistika e përgjithëshme shëndetësore për vjetin 1926, botuarë prej Drejtoris' së Përgjithëshme së Shëndetësisë, shtypurë në Tiranë; 56 faqe të mëdha.

Do të donja që kjo broshurë të ishte në duart e çdo njeriu, të çdo burrë Shteti, ministër, senator, deputet, prefekt, drejtor dhe mësues shkollë, dhe të gjithëve Shqipëtarë, aqë lënda dhe fryma e saj më du-

ketë me rëndësi, kaqë mësimet që munt të marrim më dukenë të mëdhenj.

Ná këtú, në parëthenëje, një ankim mbi ignorercën e popullit të-në që s' kupëtón akoma vleftën dhe kuptimin e shëndetësisë dhe mjekësimit; nga mungesa e mjekëvet në Prefekturë dhe krahinat e malësi-së; nga mos pasja e mjetevet në qendrë të zyrësë, shkak i rjedhurë nga pakica e bydxhetit të shëndetësisë, 300 mijë franga ar, një e shtatëdhjettë e bydxhetit të tërë të Shtetit, kur mejtohemi se Shqipëria s' ka më te-prë nga 20 miliunë të ardhura në mot dhe që të pakën 12 miliunë i konsumón ushtëria.

E tërë Shqipëria ka sot 103 mjekë, 50 farmiaci, 21 dentistë, 8 mamí. Heqim edhe ne vërejtjen mbi numurin e pakët të mamivet, jo dot një për 100,000 frymë, gjë padyshim që na shpiegon vdekjësín' e ka-lamajvet të vegjël. Pas pakicës së mamivet vien ajo e spitalevet: ve-tëm shtatë (Tiranë, Vlorë, Gjinokastrë, Korçë, Elbasan, Berat, Shkodrë), dhe prej këtyre vetëm pësë në shkallë të pothua një spitali, me nga 50 shtretën, kur se dy (Berat dhe Elbasani) nuk kanë veç se një dis-pensar me 15 dhe 10 shtretën.

Me gjithë këta mjete të pakë, domethanë me një minimum të ho-llash skandaloze, degat e shëndetësisë janë kujdesurë të bëjnë një mak-simum shërbimi: 4170 të sëmurë kanë hyrë dhe dalë në të shtatë spi-talet, 53,533 veta (gra, burra, djem) kanë qënë shikuarë prej mjekëvet të spitalit ose të bashkisë, do atje ku gjërdenë spitale, do në çdo nën-prefekturë; 42 veta kanë parë tratament kundra tërbimit, në institut të Durrësit; 55 të mjerë janë mjekësuarë në çmendin e Vlorësë; dhe 65,950 veta janë shartuarë kundrë lisë.

Statistika në faqetë 7 dhe 8 mban një artikull mbi „Luftën e ma-larjes në vitin 1926“ anmikut të mortshëm që na është instaluarë në shtëpí dhe na ka hyrë në gjí; pastaj në radhët të çdo prefekturë bro-shura mban shënime mbi gjendjen nga malarja, sikundrë që nukë mun-gon të flasë edhe për të dy anmiqt' e tjerë, sifiljs dhe tuberkulosë. Dhe kundrë lëngatës' së parë, malarjesë, 227 kilogram e giysmë qinin është shpërndarë motin që shkoj, pa bërë dot gjësendi, mjerisht, kundrë smundjesë veneriane ose tuberkulozëzë.

Statistika që kemi në dorë, tër duke na rrëfyerë rrezikun e math që i paraqit vëndit dhe kombit tënë gjendja shëndetësore, sikur edhe na psheh një pjesë te këti rreziku, thotë njeriu se i vjen keq për tmer-rin që munt të siellë xbulimi i faqes' së vërtetë të punëvet; kështu, tu-berkuloza dhe sifilisi paraqiten pas shikimit zyrtar, pas atyre të pakë-ve që janë mjekësuarë ose kanë deklaruarë lëngatënë, kur se e vërteta është fort më e hidhurë. Padijënia, mungesa e kujdesit, mizera fizio-

logjike e rjedhurë nga zakonet e liq dhe nga varfëria, na bëjnë që shëndeti i popullit tënë, pa përjashtim krahine, të jetë në situatë fort të zezë, më e zezë nga ç' i rrefehetë syrit zyrtar.

Edhe ne nukë munt të heqim aqë sa duhetë vërejten e popullit t'ënë: Shqipëria sot gjëndet e çpopullësuarë, e zbraturë, e banuarë vetem me një gjindje të rallë dhe të sëmurë. Pritmi dhe sigurimi ynë varetë nga numuri dhe shëndeti i popullit. Çdo kujdes përpara kësaj pike mbetetë, dhe duhet të mbetetë, në shkallë të dytë, se çdo serd, moral, material, politik dhe shoqëror, rrojtja ose vdekja jonë, dependojnë prej çështjes së popullësisë.

Me qënë këshu ay që është më i interesuarë këtú është populli vetë, dhe atí i takón detyra e punimit, atí i përket barra e kujdesjesë, ay duhetë që të marrë masa, të mundohetë, të përpiqetë, të gjejë ilacin dhe shërimin.

Do të shënojmë këtú disa mjete:

1. dhe në krye fare krijimin e shoqërivet të gravet, që të lartësohetë situata intelektuale, morale dhe shoqënore e mëmavet, bashkë me tó e gjithë kombit, dhe kështu të përhapenë parimet e mirërrojtjesë dhe të shëndetësisë, të vizitohenë lehonatë, të varfërat, të vatë dhe jetimët, të shpëtohen' nga lëngata, nga smundjetë ngjitëse, nga dekadencia morale.

Disa vjet më parë kishin filluarë të formohenë shoqëri grash në Shkodrë, në Tiranë, në Vlorë, në Korçë, në Gjinokastrë, të gjitha sot — për turpin dhe faqen e zezë t'ënë! — të çdukura, pos asaj së Gjinokastrës.

2. Të formohenë shoqëri sportife që të lartësohetë, të përmirësohetë dhe të ndreqetë gjendja fizike dhe shëndetësore e njeriut, të shpëtojnë të rinjtë t'anë nga mefshtësija që siell smundjetë dhe varfërinë; të ngjalletë dhe të forcohetë gjaku i rëmbavet të tyre.

3. T' i jipetë shvillim organizimit të boyskautizmësë, që të munt një kjo Shqipëria jonë të ketë, jo vetëm disa mijë diem të shëndoshë trupësisht dhe idealisht, po edhe aqë policë të shëndetësisë dhe të moralitetit të përgjithshim.

4. Të zgjuhetë fryma e ndihmësë dhe e mirëbërjesë, e dhuratavet për instituta njerëzore; t'á ketë për nder dhe për detyrë shpirtënore që të japë makar një ovull të voglë për një spital, për një jetimore, për një shoqëri që lehtëson vuajtjet dhe shëron plagët tóna.

Edhe këtú duhet të flasim pakë për Kryqin e Kuq, për këtë ndihmës të Drejtoris' së Shëndetësisë.

Motin 1926 Kryqi i Kuq përndau dyzet kilogram qinino dhe në dispensar të tij kanë vajturë, motin 1926, në teprë se 2,000 veta (gra, kalamanj, burra) që të vizitohenë prej mjekut.

Nga ana tjetrë, është krijuarë më 28 Qershor 1926, në Kryq të

Kuq, shërbimi i quajturë *Pikë qumështi*, në të cilët foshnja të vegjël shpihenë për t'u vizituarë prej mjekut, ose, ata, mëmat e të cilëvevet s'kanë qumësht, për të marrë t'amël të sterilizuarë.

Në mot-mot, qershor 1926 - qershor 1927, kanë vajturë 634 foshnja të shikohen ne *Pika qumështi*, dhe 83 foshnje sot janë tue marrë çdo ditë 34 kilogram t'amël, të ndarë në 250 biberonë.

Statistika tregtare e importacionit dhe eksportacionit për motin 1926, botim i Ministris' së Financave, Tiranë; 279 faqe, në format të math.

Për të dymbëdhjet muajt e kaluarë suma tregtare e vëndit tënë shifrohetë me 36 miliu 828 mijë franga ar, prej të cilave 24,964,731 për imporimet e plaçkave nga vëndet e huaj, dhe 11,963,982 vlefta e sendeve të që kanë dalë nga Shqipërija.

Importacioni, pra, arrin ma teprë se dy herë çmimin e eksportimeve, kur se motin 1925 ishte 21,8 me 16,1.

Statistika mban gjithë hollësinat e regjistruara në teltet e doganave t'ona, sikundrë që e ka bërë në të gjashtë këta vjet të fundit. Nukë do të analizojmë kaptinat, as edhe të derdhim lot mbi diferencën e importimeve me eksportimet që bëjmë, as edhe të përpiqemi të dëftojmë se importacionet jan' edhe më të mëdhenj nga ç' është shënuarë në botimet zyrtarë, kur sasi e eksportimeve munt të shikohet' e sigurtë.

Ajo që më heq vërejtjen dhe më pikëllon është suma e voglë e tregëtis' së në, e blerje dhe shitjeve të një kombi të lërë, të një Shteti, sumë që padysni n, në vënde të tjerë, përfaqëson transaktimet e më të vegjëlve të qytelëve.

Pakësimi i eksportimit relativisht me motin 1925 është pjesërisht nga shkak i prodhimit të ullinjve, po edhe nga pakësimi i çdo prodhim tjetër i tokës' së në, me qënë se nuk kemi asnjë send industrije për të shiturë. Atëherë vjen pyetja për neve: ç' bëjmë për të shtuarë të dhënë e dheut? për të zgjeruarë dhe përparuarë bujqësinë, këtë sisen e qumështit tënë?

E dimë që në disa krahina, si në Skrapar, sipërfaqe e tokësë që punohetë, është shtuarë, arrat janë shumuarë, në barabitje të gjendjes paralufte; mjerisht në shum krahina të tjera të Jugës, nga shkak i shkretimeve të motit 1912-1914, toka filloj të mbesë djerë, dhe Myzeqeja jonë, ay vënt që munt të bëhetë një grunar i vërtetë, po sheh tokën e lëruarë një herë, sot të kthehetë në lëndinë dhe kullota.

Duhetë një volum njëzet herë sa një numër i Diturisë që të numuronj ç' na mungon në këtë lëmë dhe ç' munt që të bëjmë. Dua

të tërheq vetëm kujdesin e këndonjësit t' im mbi detyrën e çdo qytetasi Shqipëtar për shvillimin e bujqësisë dhe ameliorimin e blegtorisë, me qënë se bydzheti i Shtetit t'ënë është varurë ne përparimi i këtyre dy burimeve të pasurisë kombiare, dhe rrojta e kësaj Shqipërije është varurë ne shvillimi ekonomik dhe ne shtuarja e të ardhuravet të saj. Sot bydzheti ynë, me gjithë parashikimet optimistë nuk' kalon të 20 milion frangat ar. Nga ana tjetër, tani që kemi marrë një hua, po gjendemi si ay njeri që ka lënë shtëpinë *vefa* dhe që ka rrezikun e shitjesë mbi krye; dhe kështu shtimi i të ardhuravet është një çështje rrojte ose vdekjeje për neve.

Ashtu prapë, në qoftë se gjer më sot, puna dhe punimi kanë qënë një qejf ose një luks, që tani e tutje duhet të jetë një detyrë — dhe një detyrë imperatife — për çdo Shqipëtar: nukë duhetë që as katundari as edhe beu të lenë tokën djerr, dhe kështu puna, dhe jo përtimi, duhet të bëhetë parimi i jetësë.

Pas punësë që duhet tã ketë detyrë çdo njeri, zyrtarisht do t' ishte nevojë që t' i jipësh më teprë kujdes bujqësisë, dhe të mos vonohësh më teprë krijimi i drejtoris' së përgjithëshme të tregëti, industrí dhe ekonomisë kombiare, ashtu sikundrë që është vendosurë pësë vjet më parë, zyrë aqë më e nevojëshme sa sot nuk' ka as një organ kompetent për kujdesjen e ngjalljesë ekonomike të vëndit, aqë më pakë për t' u bërë udhëheqës i Shqipëtarëvet*.

Krijimi i do udhëve — qoftë dhe provizore — si ajo e Korçë dhe Beratit me Durrës, duhet të jetë një shënjë për një punim me zel dhe vullnet. Do të ishte dhe ndoshta një masë plot urtësi sikur — duke mejtuarë që automobilët sot janë udhët e hekurta tona dhe i vetmi mjet për eksportim gjëje dhe shvillim ekonomik — të ngrihësh taksa e benzinës, e llastikavet dhe e karocavet, taksa që pengojnë prodhimtarin dhe, tërthorazi, ndalojnë ameliorimin e bydzhetit të Shtetit.

Dialëria, vjet VIII volum II Nr. 1, maj 1927, Shoqëria e studentëvet Shqipëtarë „Albania“ Vjenë.

E përkohëmeja që kishte pushuarë ca kohë, tani filloj të dalë prapë, dhe salutojmë me një miqësi të veçantë këtë manifestim të studentëvet tånë, të atyreve që përpiqenë të fitojnë dituri dhe të bëhenë njerës me mëndje dhe vetija serioze.

* Më 3 Tetor 1925, Z. Milto Tutulani, si ministr i Drejtësisë në kabinetin e formuarë rishtazi, duke kërduarë programin e qeverisë përpara dhomës' së deputetëvet, tha se, „qeveri e ré do të krijonte Drejtorin' e Tregëti dhe Industrisë, në krye të së cilësë do të vihetë një specialist“.

Nga artikujt shënojme: Ujt në pikëpamjen e shëndetësis; Merkantilizmi bilanca e tregtisë dhe e pagesave; Shvillimi ekonomik i Shqipërisë; Zehet e Shqipërisë së veriut; Sëmundjet gjenitale, rreziqet dhe të luftuemit e tyre... si edhe 5 vjersha, prej të cilave na vjen keq që nuk e produkojmë dot këtu atë të titulluarë *Galatesë*, prej Edhem Haxhiademit.

Numurimi i artikujve nuk jep dot një idë për vlefën e tyre, sidomos të atyreve që e kanë subjektin merkantilizma, shvillimi ekonomik, zehet (minat) dhe do të donim që Dialëria të ishte në çdo dorë, në çdo shtëpi, jo për formatin e bukur dhe figurat e kandshme që e hieshojnë, po që të këndohetë me vërejtje dhe të kupëtohetë fryma e saj, shpresa që tingëllon në përparimi prej punësë dhe punimit.

Pse të jem i shtrënguarë të rrëfenj këtu një hidhërim, atë njollë të zezë të faqesë 3 të kapakut, atë reklamë të Greilinger-it, „qendra e Shqiptarvet? Greilinger, në Vjenë, La Tour, në Romë, Palladion në Athinë, a nuk janë sicilado një faj që u është reproshuarë studentëvet tanë? a nuk janë dergjëje ku humbet inteligjencia dhe aktiviteti i të rinjvet tanë, magniti që i bën të deviojnë hapat e tyre prej biblioteka dhe akademivet, prej sallave të mësim dhe konferencave? A s'kanë dalë njerës që të kallzojnë djalërinë t'ënë duke thënë se, atë po përpiqenë, jo për dituri dhe kulturë, po vetëm për një copë diplomë!

E dimë se shumë prej miqvet të rinj të mij do të më kujtojnë gjëndjen financiare të studentvet, pothua se të gjithë bursierë, duke qënë se teororira e prindvet akoma s'është bërë modë keq; e di do të më thonë vuajnë nga paregullsi e pagesësë dhe nga vështirësi e jetësë. Po, në qoftë se mësimi dhe studimi kanë për qok naltësimin dhe forcimin e moralit, të mëndjesë dhe të shpirtit, ç'është munt që të na japë më të madhe fuqi kundra mizerave materialë, se stoikërija që na frymëzon dija?

E di që këta të qërtuarë janë për një pakicë të rinjvet t'anë, dhe më pëlqen të besoj se shumica punon për një shvillim të zëmres dhe të shpirtit, për kulturë të vërtetë, me durim dhe modesi pa humburë një minutë nga koha e vlefshme e tyre, të lumturë për kapitalin frymor që po mështriellinë dhe për qytëtasit e ndershim që i përgatitin Shqipërisë s'ënë.

Leka i Math, poemë shqiptare legjendare, prej Ilo M. Qafëzezi, Korçë 1927.

Zotin Ilo Qafëzezi e njohim nga libri të që na ka dhënë më parë: *Histori e Ali pashësë*, dhe prej veprave *Si u gjent Amerika, Bonaparti*,

Rrësku arbëror. Këtë radhë po na jep një farë jetëshkrimi të Aleksandrit të math, një biografi legjendare dhe popullore, ashtu sikundër që kanë paturë edhe gjuhët e tjera të Balkanëve, dhe, me qëllim që të jetë fare popullore, autori e ka vënë në vjershë, me një zell patriotik dhe historik të tij.

Padyshim që nga kjo libër nukë presin no një besnikëri historiani, as edhe no një kritikë të legjendësë pakë si përallore të atë që me famën e tij heroike mbushi gjithë shekujt e njerëzisë gjer më sot.

Po Ilo Qafëzezi shkron këtë radhë për njerin e popullit, në mënyrë që ka këngëtuarë vetë kombi ynë, dhe disa vjersha, në enthuasismë të tij, si këto :

Pastaj i thanë Shqipëtarit : shko mbretit Lekë i thuaj
 Që n' Athinë gjer më sot s' ka hyrë barbar i huaj..
 Anthinonjët rreth e rrotull kalasë na kishin vënë
 Barut, sufur, nër ll-gëme dhe pak njerës kishin lënë..

Kjo vjershë, themi, na kujton këngën :

Kush u-hoth proto n' Athinë,
 Ki Çelo Picari inë!

me gjithë që libra e sotme flet për një epokë në të cilët as Maqed' ó ni quhësh Shqiptar, as edhe baruti ishte çpikurë.

Marrim shkak nga kjo veprë të rrëfej-në shpresën a do të dalë kush të na përkthejë librat e Plutarkut, jetëshkrimet dhe copët morale të 'ij, duke qënë se një përkëthim i gjatë, më një gjuhë mesatare të-nën, me durim dhe kritikë, do të bëjë tër atë shërbim që i pruri frëngjishtesë puna e eruditit Amiot, me përkthenjës, fjeshtësinë, hollësinë dhe begatinë që i dha foljesë.

Disa, ndoshta, do më bëjnë fjalë prej vështirësivet materiale, pekuniare, që i bratë nuk shitenë. Unë, do te marr lejën, dhe t'i pyes : ku m' a kanë zotësinë intelektuale, le të m' a rrëfejnë që t' a shoh. Në më thëncin, si Arkimedë të rinj, se pika e mpështetjes është paraja, do të përgjigjem : Jo vetëm pika e mpështetjesë, po edhe maniveli që munt të kthejë dhenë, s' është veç se intelijenca.

Sh. Luigji Gonzaga, teatro me tre akte, Shkodrë 1927.

Bota katolike festoj motin 1926 të dyqintvjetin e kanonizimit të Luigj Gonzagut, shënjtit Jezuit që venerohet si patron i të rinjvet. Shqipërija bashkë me festimin fetar, pati fatin të fitojë me këtë rasje

edhe një veprë literare, teatron që kemi përpara, shkruarë prej autorit që na ka mesuarë kurdoherë të na japë vjersha të bukura dhe të nalta.

Padyshim se literatura katolike në Shqipëri është e vjetër, i pari manifestim për të ruajturë gjurmët e idevet, për të materializuarë mendimin. Jemi të lumturë të shohim sot edhe poezija dhe ideali të shoqërohetë në ndjenjatë fetare.

Jemi të konviktuarë se feja, si manifestim i sentimentalitetit dhe i misticismësë, ka nevojë për ideal dhe poezi për t' u-ushqyerë. Ajo që bën bukurin e therorisë dhe naltësin e akteve heroikë, ajo që e ka shtyturë fetarin në misione të vështirë ose q' i ka inspiruarë theksat e larta të lirizmësë, ajo që e bën një Luigj Gonzag të renuncojë ke sunimi për të shogruarë vetëhen e tij në veprat e devoçme sa edhe të vdesë duke shërbyer të sëmurët, s' ka qënë pratika përdhese dhe e përditëshme e një besimi fjeshtë në dukje, ose fanatizma e errët, po ideali shpirtënor bashkuarë në një poezi romantike.

Salutojmë agimin e një lindjeje së tillë si një garanti për ringjalljen dhe shkëlqimin e Shqipërisë s'ënë, një dhe e pandarë, me gjithë ndryshimet superficalë të besimevet që ndjekin bijt e saj.

Ilahi, vjersha fetare, prej Sheh Ahmed Shkodrës, Krye'ar' i federatësë vllaznis Rifai të Shqipnis, Vlorë 1927.

Libra mban 21 copë në vjersha, mbi subiekte fetarë si pas udhës së Rifaiet. Nukë munt veç se të shënojmë me simpati përpjekjet e autorit për të shqiptarëzuar një seremoni që gjer më sot është bërë në gjuhë arabe dhe shikohësh si një gjë e huaj në Shqipëri. Libra na duketë dhe kaqë më e vlefshme sa, jep edhe një mendim të kthiellitë mbi esencën e kësaj sekte. Midis vjershavet nukë mundim të mos numurojmë (faqe 72) një të titulluarë *Kshilla e Kuranit mbi Kombësi*, në të cilët lartësohet ide e kombit, e lirisë dhe independencës së tij, litika që formon për njerinë dhe fenë gjuha e nanës.

Në Shqipëri kemi një shumicë teqe. Sikur siciladó prej tyre të fillonte sistemin e mësimit, e këndimit, t'á bënte detyrë të mbajë kronikat e vëndit, të regjistrojë në tefter ató ngjarje që interesojnë udhën e tyre, të bëshësh zakon studimi, padyshim që faqe e Shqipërisë në pak kohë do të ndryshohësh për lumtërin' e të gjithëve.

Këtë e themi me një besim aqë më të math sa Atë, dervish dhe myhibbët janë të stërviturë në disiplinë dhe formojnë një mjet veprimi prej më të fortëvet.

STAMLES



Dhuratë klienteve fr. ar 20,000 në vit

VAZHDONI

të pini cigaret Stamles, harmani i tyreve është bërë me duhane të vjetër dhe të zgjedhurë të Shkodrës, Elbasanit, Kasharit. Secili gjen shijën e vet në markat me famë të fabrikës Stamles :

President

Korçë

Dëfrim

Triumf

Egypt

Senat

Special

Republikë

Çdo paketë „President“ „Korçë“ „Dëfrim“ jep një dhuratë të veçantë



STAMLES

Rrëfenja popullore shqipe të ripunuara për djelmërinë, prej Prof. Mihal Sherko.

Volumi i parë do të shtypetë për së shpejti. Çmimi 2 franga ar për tekdo në Shqipëri; 50 senca dollari për jashtë. Emrat e ndihmëtarëvevet do të botohen' në funt të librësë.

Adresa : Prof. MIHAL SHERKO. - Tiranë

Pajtohuni në gazetën „**Telegrafi**“ Del në Tiranë dy herë në javë *regullisht*. Është gazeta më moderne e Shqipërisë. Boton **Lajmet** më me ëndësi, **Kryeartikujt** më të vyer, dhe **Pjesë Letrare** të zgjedhurë.

Për çdo komision tregëtije, punë dogane që të kini, drejtohuni ne **Anastas Pandeli**, komisionar, Durrës.